# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5652
E enjte, 13 dhjetor 2018
çmimi 0.40 €

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"


## Qeveria amerikane i dhuron Kosovës pajisje për policinë kufitare

FAQE 6



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BELUL BEQAJ FAQE 4-5

# Procesi i dialogut Kosovë - Serbi do të radikalizohet



Politologu Belul Beqaj ka vlerësuar se, pas ngjarjeve të fundit, procesi i deritanishëm për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë është zhvlerësuar nga ideja e korrigjimit të kufirit. Ai ka theksuar se në këtë situatë çdo ide për vazhdimin e dialogut dhe për ekip negociues është aventurë e re. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Beqaj ka thënë se ky proces do të radikalizohet, madje edhe kërkesat e palëve. Megjithatë, ai ka theksuar se kjo nuk duhet të jetë arsye për ndarje, por për zgjidhje të problemit brenda kufijve. Beqaj ka thënë se vendosja e taksës është shërbim për politikën e 'korrigjimit të kufirit' mirëpo, sipas tij, mençuri racionale do të ishte reciprociteti politik e jo ai ekonomik

## AKTUALE

### ARKANI E PARAMILITARËT SERBË KANË QENË HIÇGJË NË KRAHASIM ME ZYRTARËT SHTETËRORË TË SERBISË! F. 11



Nga Jakup KRASNIQI

### ÇDO I FTUAR NGA GJYKATA SPECIALE DUHET TË INFORMOHET SE NË ÇFARË CILËSIE FTOHET! F. 11

Nga KMDLNj

## EKONOMI

### KOSOVA DO TË PËRFITOJË DHJETËRA MILIONA DOLLARË DONACIONE NËPËRMJET MCC-së F. 8

### VETËVENDOSJA KËRKON ANGAZHIM PËR TË DREJTAT E PUNËTORËVE F. 8

# Pas ShBA-së, edhe Britania e përkrah formimin e ushtrisë

Hapin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), për ta përkrahur Kosovën për formimin e ushtrisë, e ka ndjekur edhe Britania e Madhe. Ambasadori i kësaj të fundit në Kosovë, Ruairi O'Connell, ka thënë se është e drejtë e Kosovës t'i krijojë forcat e veta të armatosura. Komandanti i Komandës së Përbashkët të Forcave Aleate në Napoli, admirali James Foggo, ka thënë se vendimi për transformimin e FSK-së në ushtri është vendim sovran i Kosovës i cili duhet të respektohet FAQE 3






# Taksa prej 100 përqindësh i shkakton mbi 23 milionë euro humbje Serbisë

FAQE 9

## KULTURË

### MINISTRI I KULTURËS KËRKON THEMELIMIN E SHKOLLËS KOMBËTARE TË BALETIT NË KOSOVË F. 13



## SPORT

### FLAMURTARI SHLYEN BORXHET NDAJ LOJTARËVE, POR THAQI MUND TË LARGOHET F. 16

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Vuçiqi: Mogherini nuk është fajtore për ndërprerjen e dialogut

BEOGRAD, 12 DHJETOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka deklaruar se shefja e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini, nuk është fajtore për ndërprerjen e dialogut, pasi fajtorë për këtë mund të jenë vetëm dy palët, Prishtina dhe Beogradi.
"Le të mendojnë mirë në Prishtinë se kush është fajtor. Të mendojnë se cila palë dëshironte dialog dhe kush nuk e dëshironte atë", ka deklaruar Vuçiqi për Televizionin publik serb.
Ai tha se shpreson se do të ketë më shumë mirëkuptim në të ardhmen dhe Prishtina do ta kuptojë se me "masa të dhunshme dhe joligjore" nuk mund të arrijë asgjë.
Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, të martën, ka fajësuar shefen për Politikë të Jashtme dhe Siguri të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, për siç ka thënë "mbytje" dhe "çrregullim" të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë.



# Pedagogët u bashkohen studentëve

Senati i Universitetit të Tiranës, edhe zyrtarisht u është bashkuar kërkesave të studentëve për qeverinë "Rama duke mbështetur protestat e tyre dhe ka kërkuar nga qeveria që të gjejë zgjidhje për problemet e tyre



Tiranë, 12 dhjetor - Pedagogët dhe stafi i universiteteve u janë bashkuar të mërkurën edhe zyrtarisht kërkesave të studentëve për qeverinë "Rama". Senati i Universitetit të Tiranës, në një deklaratë publike ka mbështetur protestat e studentëve dhe thotë se qeveria duhet të gjejë zgjidhje për problemet e tyre.
Por në reagimin e Senatit të UT-së, bie në sy një kundërshti e hapur ndaj kryeministrit Edi Rama. Senati bën të ditur se nuk është universiteti ai që ka vendosur tarifat për provimet e prapambetura, por kjo masë është marrë nga një vendim i Këshillit të Ministrave. Është i njëjti vendim që Edi Rama tha se do e anulonte menjëherë sapo nisën protestat e studentëve tetë ditë më parë.
Kjo deklaratë e UT-së është në fakt dhe një përgënjeshtrim i hapur ndaj qeverisë "Rama". Në justifikimet që kanë nxjerrë deri më tani kryeministri Edi Rama dhe ministrja Lindita Nikolla, argumenti kryesor i tyre ishte se tarifat nuk i ka rritur qeverisë, por bordet e universiteteve. Ndërkohë vetë universitet thonë se vendimi nuk ka ardhur nga ata, por nga Qeveria dhe vendimet që janë marrë nga kryeministri Edi Rama. Denoncimi që i ka bërë të mërkurën Senati i UT-së është një tjetër argument që konfirmon kërkesat e drejta të studentëve.
Ndërkohë prania e pedagogëve në protestën e studentëve është gjithnjë e më e madhe. Tashmë nuk flitet vetëm për disa kërkesa, por për një lëvizje studentore dhe intelektuale që kërkon menjëherë ndryshimin e situatës së krijuar në vend me arsimin.
Edhe në disa rrethe të Shqipërisë është protestuar.
Disa nga akset kryesore nacionale të Shqipërisë bllokohen nga protestuesit, të cilët janë të revoltuar prej çmimit të shtrenjtë të karburantit, taksave dhe papunësisë.
Duket se gjithë Shqipëria është ngritur "në këmbë", pasi nga Jugu në Veri po protestohet. Fillimisht ka qenë minatorët në Bulqizë që kanë zhvilluar një protestë ku kërkojnë "statusin e minatorit" kaq shumë të diskutuar dhe premtuar nga çdo qeveria që ka qenë në pushtet këto 28 vjet demokraci.
Edhe në Shkodër nuk kanë munguar të mërkurën protestat, pasi qytetarët kanë bllokuar hyrjen e qytetit. Ndërkohë qarkullimi i mjeteve në aksin Lushnje-Rrogozhinë është paralizuar, pasi qytetarët janë bashkuar kundër taksave të larta, kërkojnë uljen e naftës dhe largimin e qeverisë, ndërsa theksohet se protesta është thirrur nga Partia Demokratike.
Edhe në Fushë-Krujë, qindra qytetarë kanë dalë në një protestë duke bllokuar autostradën nga Miloti drejt Tiranës, ndërsa janë shprehur se janë në përkrahje të studentëve. Ata thonë se do ta përshkallëzojnë protestën duke shkuar në Tiranë në mbështetje të studentëve atje.
Në një deklarate urgjente për mediet, kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi ka kërkuar që t'i jepet zgjidhje studentëve, ndërsa tha se LSI-ja do depozitojë në Kuvend amendamentet për të zgjidhur kërkesat e tyre.
Kryetarja e LSI-së tha se koncesionet marrin 46% te GDP dhe studentët vetëm 1%.
"Shqiptarët të rrënuar nga mjerimi, të përkulur nga situata. Gjendja është kritike, mijëra studentë po përballen me mjerimin dhe arrogancën e qeverisë. Zgjidhja e problemeve është emergjenca kryesore. Mesazhi është një: plotësimi i 8 kërkesave të tyre. Kërkesat e tyre janë minimale.
Sot i propozojmë Kuvendit dy amendamente që do të zgjidhnin 8 kërkesat minimale, ndaj ftoj qeverinë që t'i miratojmë urgjentisht ato. I bëj thirrje Ramës të ulet dhe t'i përmbushë kërkesat e studentëve, pasi sot, më shumë se kurrë shqiptarët janë me studentët", deklaroi Kryemadhi.
Ndërkohë, kreu i Qeverisë, Edi Rama, mësohet se ka mbledhur me urgjencë Këshillin e Ministrave në përpjekje për t'i dhënë zgjidhje situatës së vështirë në të cilën e kanë vënë studentët protestues prej 9 ditësh.
Mësohet se Rama ka urdhëruar shkarkimin e drejtorëve të konvikteve, si shkaktarë kryesorë të pakënaqësisë së studentëve, mungesës së kushteve minimale të jetesës në godina.
Po ashtu, ka urdhëruar shkarkimin nga bordet universitare, të përfaqësuesve të qeverisë për t'u lënë hapësirë të rinjve.

## Azili i Gruevskit, sipas rregullave ndërkombëtare

BUDAPEST, 12 DHJETOR - Zëdhënësi i Qeverisë hungareze Zolltan Kovaç gjatë një konference me gazetarë në Bruksel tha se të gjitha procedurat lidhur me azilin e ish-kryeministrit Gruevski janë në përputhje me ligjin dhe rregulloret ndërkombëtare.
I pyetur nëse Qeveria hungareze ishte përfshirë në arratisjen e Gruevskit në Hungari, Kovaç u përgjigj shkurt duke thënë se "Hungari sado që është përfshirë, ka ndjekur të gjitha rregullat ndërkombëtare në përputhje me standardet ndërkombëtare".
Në lidhje me këtë, zëdhënësi hungarez u pyet nëse kjo do të thotë se nuk ka besim në sistemin gjyqësor në Maqedoni.
"Theksoj, e keni parë këtë edhe në një Tweet timin, se agjencitë e Komisionit Evropian dhe agjencitë e tjera ndërkombëtare që raportojnë për Maqedoninë kanë dhënë disa arsye se pse kjo çështje trajtohet kështu. Por edhe një herë kjo nuk ishte një procedurë qeveritare, por një agjenci e pavarur, agjencia gjithmonë ndjek protokollin e njëjtë për çdo rast individual dhe ne gjithmonë sigurojmë bazë dhe kornizë për një proces të drejtë dhe të barabartë për të gjithë", tha Kovaç.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Edhe një anëtar i NATO-s mbështet Kosovën për transformimin e FSK-së

# Pas ShBA-së, edhe Britania e përkrah formimin e ushtrisë

Hapin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), për ta përkrahur Kosovën për formimin e ushtrisë, e ka ndjekur edhe Britania e Madhe. Ambasadori i kësaj të fundit në Kosovë, Ruairi O'Connell, ka thënë se është e drejtë e Kosovës t'i krijojë forcat e veta të armatosura. Komandanti i Komandës së Përbashkët të Forcave Aleate në Napoli, admirali James Foggo, ka thënë se vendimi për transformimin e FSK-së në ushtri është vendim sovran i Kosovës i cili duhet të respektohet

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Pas Shteteve të Bashkuara (ShBA), edhe Britania e Madhe i ka thënë po transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri. Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O'Connell, ka bërë me dije se Britania e përkrah formimin e ushtrisë së Kosovës. "Mbretëria e Bashkuar beson se është e drejtë e Kosovës t'i krijojë forcat e veta të armatosura. Ne vazhdojmë ta inkurajojmë Kosovën të sillet me përgjegjësi dhe me transparencë, në konsultim me aleatët e NATO-s, dhe ta respektojë angazhimin ndaj KFOR-it, përshirë edhe shkëmbimin e letrave të vitit 2012-2013", ka shkruar O'Connell në llogarinë e vet në "Facebook", në përgjigjen që i ka dhënë një qytetari në bashkëbisedimin e hapur me qytetarët.

Edhe komandanti i Komandës së Përbashkët të Forcave Aleate në Napoli, admirali James Foggo, është shprehur pro formimit të ushtrisë së Kosovës. Ai ka thënë se vendimi i autoriteteve të Kosovës për ta transformuar Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri është një vendim sovran dhe ne mbetet ta respektojmë. "Kosova është një demokraci e njëjtë ashtu siç janë Maqedonia dhe Serbia ku qytetarët votojnë personat të cilët marrin vendime në emër të tyre", ka thënë admirali Foggo në një konferencë për media në Shkup, pas takimit që ka realizuar me ministren e Mbrojtjes së Maqedonisë, Radmilla Shekerinska. Sipas tij, ky vendim u takon institucioneve të Kosovës. "Nga këtu them se ky është një vendim sovran të cilin do të duhet të bëjë Kuvendi i Kosovës për transformimin e FSK-së", është shprehur Foggo.

Edhe zyrtarët më të lartë shtetërorë të Kosovës kanë bërë me dije se Kosova po e bënë ushtrinë në koordinim me aleatët e saj. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në një intervistë për "Zërin e Amerikës" ka thënë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës e përkrahin transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe se transformimi i FSK-së në ushtri do të votohet më 14 dhjetor. "Shtetet e Bashkuara të Amerikës e përkrahin transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ne do ta votojmë më 14 dhjetor. Drejtimi ynë si shtet është shumë i qartë, si komb, Perëndimi, Bashkimi Evropian, NATO, partneriteti shumë i veçantë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe do të ecim në këtë rrugëtim të përbashkët. Po besoj shumë se zoti Stoltenberg do të ketë qëllime të mira dhe do ta kuptojë si një e drejtë legjitime e jona. Ne jemi shtet i pavarur dhe sovran, përndryshe atëherë cila është logjika e funksionalitetit të shtetit tonë?", ka thënë Veseli.



Përveç pozitës, edhe subjektet opozitare kanë bërë me dije se të premten do të votojnë pro transformimit të FSK-së në ushtri. Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka bërë me dije të mërkurën, në një konferencë për medie, se Kosova si çdo shtet tjetër duhet ta ketë ushtrinë e vet. "Në përputhje me vendimet e Këshillit të Përgjithshëm, LDK-ja në seancën që pritet të mbahet këtë të premte do ta mbështesim pakon e ligjeve për transformim të FSK-së. Republika e Kosovës si çdo shtet tjetër e gëzon të drejtën për t'i pasur forcat e veta të armatosura", ka thënë ai.

Ai ka falënderuar gjithë partnerët e Kosovës që e kanë mbështetur në këtë proces. "Duam të shprehim falënderim ndaj ShBA-së dhe partnerëve të tjerë për mbështetjen e këtij transformimi. Jemi munduar që prej shpalljes së pavarësisë që ky transformim të ndodhë në pajtim me të gjitha komunitetet. Të gjitha komunitetet duhet të ndihen të sigurt sepse forcat e sigurisë janë në shërbim të të gjithëve. Forcat e Sigurisë do të kontribuojnë për sigurinë e paqes dhe stabilitetit në rajon", ka thënë Hoti.

Kuvendi i Kosovës të premten pritet të votojë në lexim të dytë pakon prej tri projektligjeve për transformimin e FSK-së në ushtri. Në lexim të parë, kjo pako e ligjimeve ka marrë votat e mbi 100 deputetëve.

## GGD-ja diskuton me studentët për miratimin e buxhetit

PRISHTINË, 12 DHJETOR (ER) - Grupi i Grave Deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës (GGD), i udhëhequr nga kryetarja Mexhide Mjaku-Topalli, ka organizuar tryezë me studentë të cilët ndjekin studimet në drejtimet: Administratë Publike, Juridik dhe Shkenca Politike. Ky takim për qëllim kishte diskutimin mbi procesin e përcaktimit të prioriteteve buxhetore nga Qeveria, dëgjimin dhe konsultimin me qytetarët, si dhe implikimin e ndarjeve buxhetore nga perspektiva në baza gjinore.

Kryetarja Mjaku-Topalli i ka njoftuar studentët me procesin ligjvënës në Kuvend si dhe me rolin e deputetëve dhe të komisioneve për ndarjen buxhetore.

Pjesëmarrëse në këtë takim ishin edhe anëtaret e tjera të Bordit të GGD-së: Teuta Haxhiu, Fatmire Kollqaku si dhe Blerta Deliu, ndërsa deputetja Safete Hadergjonaj bëri prezantimin e punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa.



Në këtë tryezë diskutimi morën pjesë një numër i konsiderueshëm i studentëve të cilët zhvilluan debat dhe shtruan pyetje në adresë të deputeteve siç janë: ndarja e buxhetit në fushën e arsimit, shëndetësisë, formimin e FSK-së, ndarja e buxhetit në baza gjinore, shkelja e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat lidhur me pushimin e lehonisë etj.

Kryetarja Mjaku-Topalli dhe deputetet e tjera u përgjigjën në pyetjet e studentëve, duke dhënë sqarimet e nevojshme lidhur me çështjet e ngritura.

Flet për "Epokën e re", Belul Beqaj

# Procesi i dialogut Kosovë -



Politologu Belul Beqaj ka vlerësuar se, pas ngjarjeve të fundit, procesi i deritanishëm për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë është zhvlerësuar nga ideja e korrigjimit të kufirit. Ai ka theksuar se në këtë situatë çdo ide për vazhdimin e dialogut dhe për ekip negociues është aventurë e re. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Beqaj ka thënë se ky proces do të radikalizohet, madje edhe kërkesat e palëve. Megjithatë, ai ka theksuar se kjo nuk duhet të jetë arsye për ndarje, por për zgjidhje të problemit brenda kufijve. Beqaj ka thënë se vendosja e taksës është shërbim për politikën e 'korrigjimit të kufirit' mirëpo, sipas tij, mençuri racionale do të ishte reciprociteti politik e jo ai ekonomik

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Njohësi i proceseve politike, Belul Beqaj, ka thënë të mërkurën se me Serbinë duhet të kemi reciprocitet politik e jo ekonomik. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se vendosja e taksës ndaj produkteve serbe në mënyrë indirekte është shërbim për politikën e "korrigjimit të kufirit". "Mendoj se mençuri racionale do të ishte sikur në këtë udhëkryq të vendosej reciprociteti politik (njohja e dokumenteve shtetërore ) e jo ai ekonomik", ka deklaruar Beqaj. Politologu Beqaj ka vlerësuar se pas ngjarjeve të fundit procesi i deritanishëm për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë është zhvlerësuar nga ideja e korrigjimit të kufirit. Ai ka theksuar se në këtë situatë çdo ide për vazhdimin e dialogut dhe për ekip negociues është aventurë e re. "Procesi do të radikalizohet, madje edhe kërkesat e palëve. Mendoj se kjo nuk duhet të jetë arsye për ndarje, por për zgjidhje të problemit brenda kufijve", është shprehur ai.

Ndërsa sa iu përket dorëheqjeve të kryetarëve të komunave në veri të vendit, Beqaj ka deklaruar se skenari është në fazën serioze të shqyrtimit dhe, sipas tij, problemi i vogël po mundohet të zgjidhet duke krijuar një problem të madh me pasoja të paparashikueshme. "Kreatorët e skenarit janë të gatshëm t'i sakrifikojnë 2-3 mijë kilometra katrorë të veriut me serbët që jetojnë në jug të Kosovës. Problemi i vogël po mundohet të zgjidhet duke krijuar një problem të madh, afatgjatë, regjional dhe me pasoja të paparashikueshme", ka thënë ai.

**"Epoka e re":** *Z. Beqaj, vendi ynë këto ditë po ballafaqohet me disa zhvillime politike të rëndësishme. Cili është komenti juaj për këto zhvillime?*

**Beqaj:** Mendoj se pas ngjarjeve të fundit procesi i deritanishëm për normalizimin e raporteve është zhvlerësuar nga ideja e korrigjimit të kufirit. Lidershipi politik do të korrë atë çfarë ka mbjellë. Por, edhe qytetarët duhet të vetëdijesohen se janë bashkëfajtorë të degradimit të shtetit me faktin se nuk po kuptojnë se roli i tyre është më i rëndësishëm se i pushteteve që nuk po i sanksionojnë, nëse nuk dëshirojnë t'i përjetojnë vazhdimisht pasojat e dështimeve të politikanëve që i kanë votuar. Shikoni çfarë po bëjnë francezët. Nëse dhjetëra herë i përsërisim gabimet e njëjta, nuk meritojmë pushtete më të mira. Ne duhet ta shikojmë veten në pasqyrë. Na mungon vetëvlerësimi real. Nuk mund të na vlerësojnë të tjerët kur ne nuk krijojmë vlera. Në vend të zhgënjimit, qytetarët duhet të kuptojnë pse francezët e detyruan Makronin

# Serbi do të radikalizohet



t'i rishikojë politikat që i aprovoi kohë më parë kundër interesave të tyre, e shtetasit e Kosovës tolerojnë plaçkitjet flagrante të pushtetarëve. Kemi problem me vetëdijen politike. Duhet të zgjohemi!

**"Epoka e re":** *Si e shihni situatën në veri dhe zgjidhjen e saj pas dorëheqjes së katër kryetarëve të komunave në këtë pjesë?*
**Beqaj:** Skenari është në fazën serioze të shqyrtimit. Kreatorët e skenarit janë të gatshëm t'i sakrifikojnë 2-3 mijë kilometra katrorë të veriut me serbët që jetojnë në jug të Kosovës. Problemi i vogël po mundohet të zgjidhet duke krijuar një problem të madh, afatgjatë, regjional dhe me pasoja të paparashikueshme.

**"Epoka e re":** *Pavarësisht prej thirrjeve të ndërkombëtarëve, Kosova mbetet e përkushtuar që ta mbajë në fuqi taksën ndaj produkteve serbe deri në njohjen e Kosovës nga Serbia. Prisni të ketë rezultat ky vendim, apo presioni do ta bëjë të vetën dhe taksa do të hiqet?*
**Beqaj:** Taksa është në mënyrë indirekte shërbim për politikën e 'korrigjimit të kufirit'. Mendoj se mençuri racionale do të ishte sikur në këtë udhëkryq të vendosej reciprociteti politik (njohja e dokumenteve shtetërore), e jo ai ekonomik.

**"Epoka e re":** *Pas dështimit për liberalizimin e vizave dhe vendosjes së taksës ndaj produkteve serbe, është ashpërsuar diskursi i politikës në Kosovë karshi Bashkimit Evropian. Do të ketë efekt kjo në procesin integrues?*
**Beqaj:** Mendoj se formimi i çdo ekipi negociues është vetëm një aventurë e re në situatën kur publikisht është thënë nga kryetari i Serbisë se nuk do ta vazhdojë dialogun pa u hequr taksa e vendosur për mallrat dhe se kurrë nuk do të njohë pavarësinë e Kosovës, në anën tjetër deklarimi publik i kryeministrit të Kosovës se nuk do të hiqet taksa derisa Serbia nuk do ta njohë pavarësinë e shtetit të Kosovës. Pra, nëse i marrim parasysh këto deklarata, çdo ide për vazhdimin e dialogut duket aventurë e re, pavarësisht se nga kush do të përbëhet.

**"Epoka e re":** *Si e shihni vazhdimin e procesit të dialogut Kosovë - Serbi pas këtyre zhvillimeve dhe a besoni se spektri politik në Kosovë do të mund ta gjejë formulën për arritjen e një konsensusi për dialogun?*
**Beqaj:** Procesi do të radikalizohet, madje edhe kërkesat e palëve. Mendoj se kjo nuk duhet të jetë arsye për ndarje, por për zgjidhje të problemit brenda kufijve.

**"Epoka e re":** *Z. Beqaj, pavarësisht prej vërejtjeve të NATO-s, Kosova me mbështetjen e ShBA-së të premten do t'i votojë projektligjet që kanë për synim transformimin e FSK-së në ushtri. Çfarë mendimi keni për ecurinë e këtij procesi?*
**Beqaj:** Ballkani është ndër shekuj 'fuqi baroti'. Në vend se të demilitarizohet, ende luftëtarët po i bëjnë politikat. Serbia nuk ka nxjerr kurrfarë mësimi nga e kaluara, Kosova po mundohet ta imitojë Serbinë. NATO-ja e ka krijuar shtetin, NATO do të mbetet në Kosovë derisa Kosova të anëtarësohet në NATO. Më mirë ta kemi NATO-n në Kosovë sesa të rinjtë tanë t'i dërgojmë në misione të NATO-s.

## IKD-ja: Vetingu do t'i pastronte institucionet nga zyrtarët e korruptuar

Prishtinë, 12 dhjetor - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe Instituti Columbus të mërkurën kanë mbajtur tryezën "Integriteti, llogaridhënia dhe efikasiteti i sistemit të drejtësisë - nevoja për vetting", si aktivitet në kuadër të "Javës Kundër Korrupsionit 2018". Në këtë tryezë u publikua raporti i përbashkët i IKD-së dhe Institutit Columbus me titull "Vetingu pa alternativë", në të cilin janë prezantuar raste konkrete që dëshmojnë kapjen e institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë, si policia, prokuroria dhe gjyqësori nga politika dhe grupet e interesit në Kosovë. "Prej vitit 2010 e deri më tash sistemi i drejtësisë, përfshirë policinë, prokurorinë dhe gjyqësorin, janë përfshirë në shkelje të shumta ligjore dhe skandale të përmasave të mëdha, të cilat e kanë ulur besimin e qytetarëve në këto institucione. Sistemi i organit të ndjekjes në shumë segmente ka dështuar në ndjekje të kryerësve të krimeve, sidomos kur bëhet fjalë për profilin e lartë. Zyrtarët e lartë shtetërorë si përfaqësues politikë, jo në aspektin formal, por në aspektin praktik, janë ndikuesit e drejtpërdrejtë për rekrutimin e gjykatësve dhe prokurorëve si dhe për emërimin e pozitave kyçe në sistemin e drejtësisë. Kjo ka ndikuar që sistemi i drejtësisë të ketë gjykatës dhe prokurorë, sidomos në udhëheqje, që kanë lidhje të afërta apo janë "argatë" të drejtpërdrejtë të politikanëve të caktuar në pozita të larta shtetërore", është thënë në komunikatën e IKD-së.

Sipas kësaj komunikate, një prej shpjegimeve të kapjes së shtetit është politizimi i skajshëm i institucioneve publike, sidomos gjyqësorit, prokurorisë dhe policisë. "Krerët e institucioneve të drejtësisë shoqërohen me të akuzuar të profilit të lartë të politikës, duke zbehur skajshmërisht besimin e qytetarëve, se rastet e tyre trajtohen në bazë të ligjit. Në anën tjetër, mosndëshkimi i veprimtarive të korrupsionit, sidomos të profilit të lartë, dëshmon për amnistinë e tërësishme që u bëhet politikanëve të korruptuar. IKD ka ngritur shqetësime për dukurinë e amnistisë së zyrtarëve të profilit të lartë ndaj të cilëve qëllimisht ngrehën aktakuza pa mbështetje të provave dhe dëshmive, të cilat rrëzohen në Gjykata, duke u krijuar imunitet përjetësisht për të mos u ndjekur për veprat e njëjta", është theksuar në këtë komunikatë.

Sipas IKD-së dhe Columbus, gjendja e krijuar ndër vite mund të ndryshohet vetëm përmes vetingut, i cili duhet ta përfshijë policinë, prokurorinë dhe gjyqësorin. "Procesi i vetingut është thelbësor në fillimin e zbatimit të një reforme të thellë drejtësie për shkak se një sistem i pavarur dhe i paanshëm i drejtësisë ndikon në vendosjen e sundimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës në Kosovë. Republika e Kosovës nuk mund të synojë respektim të sundim të ligjit pa përfshirjen e policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit në një veting të thellë, i cili do t'i largonte nga sistemi policët, prokurorët dhe gjykatësit që janë të afërt me politikën, që kanë shërbyer për interesa politike dhe të grupeve të interesit, që kanë dëshmuar performancë të dobët gjatë ushtrimit të detyrave, që kanë krijuar pasuri të pashpjegueshme etj. Një proces i thellë i vetingut duhet ta ketë konsensusin e të gjitha partive politike dhe duhet të përgatitet dhe udhëhiqet ekskluzivisht nga partnerët ndërkombëtarë si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe dhe Gjermania", është thënë në komunikatën e IKD-së.

Gjatë tryezës, panelistët dhe pjesëmarrësit debatuan për tri çështje kryesore: integritetin e institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë në Kosovë, llogaridhënien dhe efikasitetin e tyre.



# Qeveria amerikane i dhuron Kosovës pajisje për policinë kufitare

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme është mbajtur të mërkurën ceremonia e pranimdorëzimit të donacionit të dhuruar nga Qeveria Amerikane përmes programit EXBS për Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policinë Kufitare, Qendrën Kombëtare për Menaxhim të Kufirit, Ministrinë e Financave-Dogana e Kosovës, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore. Me këtë rast, zëvendësministri i Punëve të Brendshme, njëherësh Koordinator Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Kufirit, Isa Xhemajlaj, ka falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës për ndihmën e vazhdueshme që kanë dhënë për ngritjen e kapaciteteve për institucionet e sigurisë në Kosovë. Ai ka theksuar se këto pajisje do ta ngrehin edhe më tej cilësinë e kontrolleve të agjencive të zbatimit të ligjit dhe do t'i ndihmojnë zyrtarët e shtetit të Kosovës që ta kenë më të lehtë t'i kryejnë veprimet e tyre operative.

Ndërsa përfaqësuesi i EXBS-së, Georger Clarke, ka theksuar se ndihma e sotshme është në kuadër të mbështetjes për Agjencitë e Zbatimit të Ligjit në Kuadër të Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe do të ndihmojë edhe më tej në punën e përditshme të këtyre agjencive. Ai ka falënderuar të gjithë Agjencitë e Zbatimit të Ligjit për bashkëpunimin e mirë që kanë pasur deri më tani dhe shpreson se do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Pajisjet do të shërbejnë për zgjerimin e mundësisë që Qeveria e Kosovës përmes mekanizmave të zbatimit të ligjit ta rrisë sigurinë edhe më të madhe në kufi, për kontrolle më strategjije të tregtisë, analizë të riskut dhe veprime për mbrojtje nga rrezatimi.




# Ministrja Hoxha: Austria ka qenë, është dhe mbetet aleate besnike e Kosovës



PRISHTINË, 12 DHJETOR (ER) - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Republikës së Austrisë në Republikën e Kosovës, Gernot Pfandler, me të cilin ka diskutuar për proceset integruese, në veçanti për çështjen e liberalizimit të vizave. "Presidenca austriake e Këshillit të Bashkimit Evropian në gjysmën e dytë të vitit 2018 rezultoi me angazhim të jashtëzakonshëm që Kosova ta fitojë liberalizimin por, për fat të keq, rekomandimet dhe ftesat e Austrisë për liberalizim nuk u përfillën nga vendet anëtare të Këshillit të Ministrave", ka thënë ministrja Hoxha.

Ajo ka thënë se Kosova është mirënjohëse për impenjimin e plotë të Austrisë gjatë presidencës së saj në krye të Këshillit të BE-së, vizitave zë zyrtarëve të lartë të Austrisë dhe agjendave të sensibilizimit me çështjen për vendet anëtare të BE-së si dhe kërkesave të vazhdueshme për ta votuar liberalizimin për Kosovën. "Konsideroj se ky angazhim ishte tejet i mirëpritur dhe jemi mirënjohës për këtë", ka thënë Hoxha në këtë takim, duke vënë në pah se Austria ka qenë, është dhe mbetet aleate besnike e Kosovës.

Ndërsa ambasadori Pfandler ritheksoi dhe vlerësoi angazhimin e ministres si dhe institucioneve të vendit për plotësimin e të gjitha kritereve, duke ritheksuar se Austria e ka mbështetur dhe vazhdon ta mbështesë liberalizimin e vizave për shtetasit e Kosovës. Ai, po ashtu, vlerësoi angazhimin për zbatimin e Reformave nga Agjenda Evropiane si dhe MSA-ja.

Ministrja Hoxha dhe ambasadori Pfandler ritheksuan gatishmërinë e çuarjes përpara të agjendës integruese të Kosovës, mbështetjen në të gjitha instancat e BE-së për Kosovën nga Austria si dhe anëtarësimin e Kosovës në institucionet regjionale dhe globale.

## Prishtina stoliset me flamuj amerikanë

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Sheshet kryesore të Prishtinës janë stolisur me flamuj të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në shenjë falënderimi për një grant të ndarë për Kosovën nga bordi i Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC).

MCC-ja ka njoftuar se i ka dhënë Kosovës Marrëveshjen Kompakt nëpërmjet së cilës Kosova do të marrë dhjetëra milionë dollarë shtesë për investime strategjike infrastrukturore, veçmas në sektorin e energjisë. "Qeveria i ka vendosur flamujt. Dje kemi marrë lajmin që MCC (Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit) i ka ndarë edhe dhjetëra miliona euro për Kosovën, investime në infrastrukturë dhe energji dhe, si shenjë falënderimi për këtë lajm dhe partneritet, i kemi vendosur flamujt", ka thënë për "Radion Evropa e Lirë", Donjeta Gashi, zëdhënëse e Qeverisë së Kosovës. Ky grant i ri i marrë nga MCC bazohet në grantin e nënshkruar prej 49 milionë dollarësh nga Marrëveshja e mëhershme e Pragut.



# Haradinaj: Do ta kalojmë faqebardhë edhe Gjykatën Speciale

Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë të mërkurën se sakrifica e popullit të Kosovës deri te liria dhe pavarësia ishte e pashembullt në historinë e re të Evropës. Ai ka theksuar se Gjykata Speciale është edhe një dëshmi se sa larg ka shkuar sakrifica jonë për një shtet të së drejtës. "Lufta e UÇK-së ishte e pastër dhe e shenjtë dhe kjo do të dëshmohet fuqishëm gjithnjë e kurdoherë", është shprehur kryeministri Haradinaj



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka reaguar të mërkurën ndaj thirrjeve të Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës për intervistimin e ish-komandantëve dhe luftëtarëve të UÇK-së. Kryeministri Haradinaj ka thënë se sakrifica e popullit të Kosovës deri te liria dhe pavarësia ishte e pashembullt në historinë e re të Evropës.
Ai ka theksuar se përgjigja e qytetarëve të Kosovës dhe ish-pjesëtarëve të UÇK-së, filtrave të drejtësisë ndërkombëtare, ka qenë e menjëhershme dhe pa hezitim. "Sakrifica e popullit të Kosovës deri te liria dhe pavarësia ishte e pashembullt në historinë e re të Evropës. Lufta jonë çlirimtare ishte e drejtë dhe e shenjtë dhe kjo është dëshmuar tashmë. Nga ne janë kërkuar gjithnjë e më shumë sakrifica dhe përballje me drejtësinë, ndonëse ne ishim viktima të agresionit. Përgjigja e qytetarëve të Kosovës dhe ish-pjesëtarëve të UÇK-së, filtrave të drejtësisë ndërkombëtare, ka qenë e menjëhershme dhe pa hezitim. Përballja jonë me furtunat e kohës është e vërtetë, e prekshme dhe e qëndrueshme, andaj askush mos të mendojë e besojë, se ky shtet është i destinuar dhe i gatshëm vetëm për përshtatje dhe akomodim të interesave të atyre që dje e humbën luftën, e sot po e rrezikojnë paqen e stabilitetin ne rajon", ka thënë Haradinaj.
Ai ka shtuar se Gjykata Speciale është edhe një dëshmi se sa larg ka shkuar sakrifica jonë për një shtet të së drejtës. "Është edhe një sfidë në rrugën tonë përpara, të cilën së bashku do ta tejkalojmë dhe nga ajo do të dalim më unikë dhe më të fortë. Siç kemi kaluar shumë vështirësi për të arritur këtu ku jemi, të gjithë duhet ta kuptojnë se si shtet dhe shoqëri edhe këtë dhembje, pas Tribunalit të Hagës, gjykatave të UNMIK-ut e EULEX-it, do ta kalojmë faqebardhë së bashku, sepse luftëtarët e lirisë gjithmonë ishin të rreshtuar me të drejtën", ka deklaruar kryeministri Haradinaj. Sipas tij, askush nuk ka të drejtë ta turpërojë Kosovën dhe të fshihet, të pengojë apo t'i shmanget drejtësisë. "Lufta e UÇK-së ishte e pastër dhe e shenjtë dhe kjo do të dëshmohet fuqishëm gjithnjë e kurdoherë. Qeveria e Kosovës do t'u qëndrojë afër luftëtarëve të lirisë të të gjitha etapave dhe është gatshme në çdo kohë ta ofrojë ndihmën e nevojshme për mbrojtje juridike", ka thënë Haradinaj.
Gjykata Speciale deri më tani ka ftuar për intervistim Sami Lushtakun, Rrustem Mustafën, Sokol Dobrunën, Nazif Mehmetin, Remzi Shalën dhe Safet Sylën.
Avokati Tahir Rrecaj ka bërë me dije se gatishmëria e ish-komandantëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) për t'u paraqitur në mënyrë vullnetare në Speciale tregon për pafajësinë e tyre. Ai është shprehur i bindur për pafajësinë e ish-komandantëve të UÇK-së të thirrur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës për intervistim. Ai i ka ftuar të gjithë t'i besojnë Gjykatës Speciale, duke shtuar se edhe një herë do të vërtetohet lufta e drejtë e UÇK-së. "Unë jam profesionist dhe i besoj një gjykate. Mendoj se të gjithë duhet t'i besojmë edhe në të ardhmen kësaj gjykate, sepse përmes këtij procesi do të vërtetohet edhe një herë pastërtia e luftës çlirimtare të Kosovës sikurse është vërtetuar deri më tani nga gjykata e UNMIK-ut, e EULEX-it dhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës. Unë dua të besoj në pastërtinë e luftës çlirimtare", është shprehur Rrecaj.

# Komisioni për të Drejtat e Njeriut dënon ndalimin e deputetit Petroviq nga policia serbe

PRISHTINË, 12 DHJETOR (ER) - Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës, në të cilën është diskutuar edhe për ndalimin e jashtëligjshëm të deputetit dhe anëtarit të këtij komisioni, Slobodan Petroviq, nga ana e xhandarmërisë serbe në kufirin Kosovë - Serbi, përkatësisht në pikën kufitare në Merdar.
Më 8 dhjetor, gjatë kalimit të kufirit Kosovë - Serbi, deputeti i Partisë Liberale Serbe, Slobodan Petroviq, është ndaluar nga policia serbe ku është mbajtur për disa orë duke u marrë në pyetje nga pjesëtarë të shërbimit informativ serb (më tej BIA). Për orë të tëra deputeti Slobodan Petroviq i është nënshtruar presionit të Serbisë për punën e tij, në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.



Në këtë drejtim Komisioni Parlamentar për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori një deklaratë prej katër pikave. "1. Dënojmë ashpër ndalimin e paligjshëm të deputetit dhe anëtarit të Komisionit Parlamentar për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve nga policia serbe. Konsiderojmë se ky ndalim bëhet me qëllim të ushtrimit të presionit dhe kërcënimit ndaj punës së deputetit Slobodan Petroviq. 2. Kërkojmë nga institucionet e Kosovës që t'i ndërmarrin hapat e nevojshëm që situata të këtilla presioni ndaj deputetëve të mos ndodhin. 3. Kërkojmë nga Zyra për Politikë të Jashtme e BE-së, përkatësisht nga përfaqësuesja Federica Mogherini, që ta ushtrojë presion tek Qeveria e Serbisë për sqarimet e nevojshme mbi arsyen dhe rrethanat e këtij rasti si dhe presionin në mënyrë që të parandalohen rastet e tilla në të ardhmen. 4. Kërkojmë nga institucionet e sigurisë së shtetit të Kosovës që me seriozitet ta trajtojnë këtë rast dhe të ofrojnë siguri për deputetin Slobodan Petroviq dhe familjen e tij", është theksuar në deklaratën e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.

# Kosova do të përfitojë dhjetëra miliona dollarë donacione nëpërmjet MCC-së

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veselit, i është konfirmuar në ShBA se Kosova do të përfitojë edhe dhjetëra miliona dollarë donacione nëpërmjet Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC). "U njoftova se Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit, MCC, ka avancuar statusin e Kosovës në programet e saj. Me këtë rast vendi ynë do të përfitojë dhjetëra miliona dollarë që do të investohen në fusha të ndryshme", ka thënë Veseli.

Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka mirëpritur vendimin e Bordit të Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit, që kryesohet nga sekretari i Shtetit, Mike Pompeo, i cili ka vendosur t'ia japë Kosovës marrëveshjen kompakt. "Më telefonoi drejtori ekzekutiv i Agjencisë Federale Amerikane - Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC), Jonathan Nash, për ta më kumtuar lajmin e jashtëzakonshëm, se Bordi i Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit, që kryesohet nga sekretari i Shtetit, Mike Pompeo, ka vendosur t'ia japë Kosovës marrëveshjen kompakt. Kosova kështu është kualifikuar të marrë dhjetëra milionë dollarë shtesë për investime strategjike infrastrukturore, sidomos në sektorin e energjisë. Ky grant është mbi grantin tashmë të nënshkruar prej 49 milionë dollarësh të marrëveshjes së mëhershme të pragut. E falënderova z. Nash për këtë lajm madhor dhe dërgova përmes tij mirënjohjen dhe urimet më të mira për sekretarin e Shtetit, Pompeo, anëtarët e tjerë të Bordit, posaçërisht miqtë në Kongres, përfshirë Eliot Engelin, që kanë ndihmuar këto vite në komunikim me Korporatën e Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC)", ka thënë Haradinaj. Ai ka shtuar se viti 2018 po na kurorëzohet me ngjyrat e shenjta të flamurit amerikan dhe aleancës së bekuar të Kosovës me ShBA-në.

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka mirëpritur vlerësimin e shtetit të Kosovës për Programin Kompakt nga ana e Korporatës së Sfidave të Mileniumit (MCC). "Ngritja e statusit të Kosovës në këtë program do t'i mundësojë vendit dhjetëra miliona dollarë amerikanë shtesë krahasuar me programin paraprak, të cilat do të mund të investohen në projekte që kanë për synim fuqizimin e sektorit privat në Kosovë, përmes adresimit të çështjeve të cilat pengojnë rritjen ekonomike të vendit, si përmirësimi i furnizimit me energji elektrike, si dhe sundimi i dobët i ligjit", është thënë në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Oda Amerikane e vlerëson të një rëndësie të madhe përkrahjen financiare të Korporatës së Sfidave të Mileniumit për zhvillimin e kapaciteteve të reja të gjenerimit të energjisë elektrike, inkurajimin e efiçencës energjetike, por edhe përmirësimin e vendimmarrjes, transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve shtetërore përmes rritjes së qasjes në të dhënat publike.

Po ashtu, Oda Amerikane vlerëson se një vendim i tillë i Bordit të Drejtorëve të MCC vjen si rezultat i angazhimit të shoqërisë së Kosovës për adresimin e sfidave me të cilat përballet vendi, para së gjithash, si rezultat i punës që bën ekipi i MCC në Kosovë si dhe Fondacioni i Mileniumit në Kosovë (MFK). "Oda Ekonomike Amerikane rikujton se programet e MCC, USAID dhe të Qeverisë Amerikane në përgjithësi, në mbështetje të shtetit të Kosovës, janë dëshmi e përkushtimit të vazhdueshëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për popullin e Kosovës", është theksuar në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

# Vetëvendosje kërkon angazhim për të drejtat e punëtorëve

Vdekjet e punëtorëve në vendin e punës janë shtuar së tepërmi gjatë vitit 2018. Rastet e publikuara në media arrijnë numrin 23. Kjo shifër nuk reflekton të gjitha rastet e tjera të pahetuara, publikuara ose të censuruara nga punëdhënësit, inspektorët dhe organet e tjera përgjegjëse. Kështu kanë vlerësuar të mërkurën, në një konferencë për media, përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje




PRISHTINË, 12 DHJETOR (ER) - Përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje kanë mbajtur të mërkurën konferencë për media në lidhje me pasigurinë dhe vdekjet e punëtorëve në vendin e punës. Në konferencë folën dy nënkryetarët e Lëvizjes Vetëvendosje, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku dhe Besnik Bislimi. Sipas tyre, 2018-a ishte vit fatal për vdekjet në punë dhe nuk u ndërmor asnjë masë as pas 23 vdekjeve në vendin e punës. Në fjalën e saj, një ditë pas konferencës së fundvitit të BSPK-së, nënkryetarja Fatmire Mulhaxha-Kollçaku ka përmendur të gjithë emrat e të vdekurve për këtë vit, duke ua bashkangjitur vendin dhe kompaninë në të cilën punonin për rastet kur këto të dhëna ekzistojnë. Ajo ka listuar edhe problematikat e punëtorëve, temë kjo e nxjerrë në plan të dytë dhe e heshtur shumicën e kohës.

Fatmire Mulhaxha-Kollçaku ka thënë se vdekjet ndodhin kryesisht në sektorin e ndërtimit, ku punëtorët punojnë pa masa sigurie. "Në këtë dhe të tjerë sektorë punëtorët punojnë shpeshherë pa kontratë dhe ku përgjegjës kryesor për vdekjet e tyre janë kompanitë punëdhënëse. Problematika të tjera që i shtohen kësaj marrëdhënie të pabarabartë janë papërgjegjshmëria e qeverive, numri i vogël i inspektorëve, mungesa e kualifikimit të tyre, mungesa e pensioneve të invaliditetit për të gjitha rastet e dëmtimeve dhe mungesa e sindikatave të forta. Format e shfrytëzimit të punëtorëve po mbarështohen në mungesë të një qeverie e cila e sheh punën dhe punëtorin si vendin ku garantohet dinjiteti i një qytetari", ka thënë ajo.

Nënkryetari tjetër i LV-së, Besnik Bislimi, ka thënë se inspektorati i punës ende punon me ligj të vitit 2002, i shoqëruar me një ndryshimplotësim të vaktë të vitit 2008 që mban siglën e UNMIK-ut. "Një shikim prej dy minutave në faqen e internetit të këtij inspektorati mjafton për të konkluduar për nivelin organizativ dhe profesional të tij. I gjithë raporti vjetor i këtij institucioni përbëhet prej tri faqeve të vetme me zero tekst të shkruar dhe tri tabela të thjeshta dhe të pasqaruara. Por mjafton të shohim se e gjithë e arritura e këtij institucioni për një vit të tërë është shqiptimi i diku 23 gjobave ndaj punëdhënësve dhe identifikimi apo trajtimi i zero rasteve të diskriminimit gjinor", ka thënë Bislimi. Ai ka përmendur edhe numrin e inspektorëve të punës që është 58 sosh kurse, sipas tij, dhjetë herë më i madh është numri i shoferëve të qeveritarëve.

Bislimi ka thënë se ndryshimi i mendësisë së qeverisjes në Kosovë është i domosdoshëm për ndryshimin e kushteve të punëtorisë. "Kosova ka nevojë për një qeverisje e cila i sheh shenjat e progresit të vendit në mënyrën se si trajtohen punëtorët e saj", ka thënë ai.

# Taksa prej 100 përqindësh i shkakton mbi 23 milionë euro humbje Serbisë




**Që nga vendosja e taksës nga Qeveria e Kosovës në 100 për qind për produktet më origjinë nga Serbia dhe Bosnja Hercegovina, kompanitë eksportuese nga këto shtete kanë humbur dhjetëra miliona euro dhe mijëra punëtorë të këtyre kompanive rrezikojnë t'i humbasin vendet e punës. Kështu është thënë në një studim hulumtues të Aleancës Kosovare të Biznesit (AKB) të publikuar të mërkurën**

EPOKA E RE — A. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka realizuar një hulumtim për periudhën 21 nëntor deri - 5 dhjetor 2018 lidhur me ndikimin e taksës 100 për qind në ekonominë e Serbisë, në të cilin kanë marrë pjesë 300 biznese, 95 prej tyre kompani serbe që bashkëpunojnë me kompani të ndryshme në Kosovë. "Gjatë kësaj periudhe, mbi 21 milionë euro llogariten humbjet e eksportit të Serbisë, 2 000 automjete transportuese nuk kanë qarkulluar për 15 ditë në Kosovë, rreth 1.3 milion euro humbje vetëm të transportit dhe mbi 8 200 punëtorë rrezikojnë të shkojnë në pushim pa pagesë", thuhet në hulumtimin e AKB-së.

Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, ka thënë se kanë mbështetur taksën 100 për qind për produktet e Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës, duke qenë të bindur se kjo do të ndikojë pozitivisht në ekonominë dhe prodhimin vendor. "Kjo do të ndikojë negativisht në ekonominë e këtyre dy shteteve që vazhdimisht kanë krijuar pengesa të lëvizjes së lirë të mallrave, bizneseve, qytetarëve dhe kapitalit, qoftë edhe transit prandaj, si e tillë, Kosova ka pasur të vetmen zgjidhje për të prekur në palcën e politikës dhe ekonomisë së këtyre vendeve që ta respektojnë Kosovën në tërësi me të mirat e veta si partner, dhe jo vetëm si vend që mund të vjelin qindra miliona euro pa i dhënë asnjë kundërshpërblim por, përkundrazi, duke aplikuar edhe barriera jotarifore ndaj Kosovës", ka thënë Shahini. Ai ka thënë se AKB-ja ka mbështetur partnerët e vet për ta realizuar hulumtim studimor mbi efektet e taksës 100 për qind në 300 biznese ku janë përgjigjur 95 kompani serbe, të cilat kryesisht bashkëpunojnë me kompanitë e ndryshme të Kosovës dhe që kanë mbi 45 000 00 punëtorë. Në këtë hulumtim për periudhën 21 nëntor - 5 dhjetor 2018 humbjet e Serbisë janë dhjetëra miliona euro. Sipas AKB-së, aktualisht bilanci monetar në mes të Kosovës dhe Serbisë është mbi 55 milionë euro të detyrimeve të hapura në mes të bizneseve të Kosovës dhe bizneseve të Serbisë. "Rreth 300 biznese kanë shprehur ankesat e veta nëpër institucione të Serbisë dhe ato ndërkombëtare për taksën 100 për qind dhe humbjen e tregut në Kosovë për shkak të politikës së gabuar dhe frikës se ato nuk do të kthehen më kurrë në Kosovë", thuhet në hulumtimin e AKB-së.

AKB-ja inkurajon kërkesën e bizneseve të Serbisë që politikanët në Serbi ta ndryshojnë qasjen ndaj Kosovës për realitetin e ri të krijuar, kurse bizneseve t'u hiqen barrierat në të dy drejtimet. "21 750 000 euro janë humbjet e eksportit të Serbisë, 39 600 tonë produkte, 2000 automjete transportuese nuk kanë qarkulluar për 15 ditë në Kosovë, 1 300 000 euro humbjet vetëm të transportit. Mbi 8 200 punëtorë rrezikohen të shkojnë në pushim pa pagesë ose të mbesin pa punë. 31 milionë euro janë mallra të Serbisë qoftë në depot doganore të Kosovës apo mallra të papaguara në Kosovë. 24 milionë euro Kosova ka mallra të paguara në Serbi e cila nuk mund t'i tërheq. 63 150 000.00 euro humbja totale e Serbisë e planifikuar në periudhën 21 nëntor - 31 dhjetor 2018", është bërë me dije në këtë hulumtim.

Importi nga Serbia në vitin 2017 ishte 449 918 000 euro, kurse eksporti nga Kosova në vitin 2017 ishte 48 246 000 euro. Më 21 nëntor Kosova ka vendosur tarifa doganore prej 100 përqindësh për produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Bashkimi Evropian i ka bërë thirrje që menjëherë t'i heqë këto tarifa, por kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se një gjë e tillë do të ndodhë vetëm kur Serbia ta njohë Kosovën.

## Qeveria e Kosovës ndan 30 mijë euro për renovimin e një shkolle në Bujanoc

PRISHTINË, 12 DHJETOR (ER) - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për ndarjen e 30 mijë eurove për renovimin e Shkollës Fillore "Naim Frashëri" në Bujanoc. Ky vendim është nënshkruar nga ministri i Financave, Bedri Hamza, ndërsa është bërë me dije nga Komuna e Bujanocit nëpërmjet faqes zyrtare në "Facebook". "Me vendin të ministrit z. Bedri Hamza, Ministria e Financave e Qeverisë së Kosovës sot ka ndarë 30 mijë euro për renovimin e katit të tretë të Shkollës Fillore 'Naim Frashëri' në Bujanoc. Një përkrahje shumë domethënëse për komunën tonë, e cila jep shpresë jo vetëm për vazhdim e projekteve të tilla, por edhe për rritjen e sasisë së mjeteve të ardhura nga Kosova", ka njoftuar Komuna e Bujanocit.



# Nis projekti për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit në 16 fshatra të Rahovecit

RAHOVEC, 12 DHJETOR (ER) - Në Komunën e Rahovecit kanë nisur punimet në projektin për ndërtimin e rreth 15 kilometrave rrjet të kanalizimit në disa lagje të qytetit dhe 16 fshatra të Komunës së Rahovecit. Nisjen e punimeve në projektin për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit nga afër e ka parë kryetari i komunës, Smajl Latifi dhe drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit. "Kanë filluar punimet në projektin e rëndësishëm për qytetarët e Komunës së Rahovecit, ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në shumë vendbanime të komunës sonë. Adresimin e kërkesave të qytetarëve për probleme të rrjetit të kanalizimit e kemi marrë me seriozitet dhe e kemi trajtuar në një projekt i cili ka filluar në fshatin Ratkoc dhe do të vazhdohet në disa lagje të qytetit dhe në 16 fshatra të Komunës së Rahovecit", ka thënë kryetari Latifi.





# Caritasi zviceran përkrah prodhimtarinë bujqësore në Mitrovicë

MITROVICË, 12 DHJETOR (ER) - Drejtori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në Komunën e Mitrovicës, Ekrem Sadiku, ka pritur në takim përfaqësuesit nga Caritasi zviceran, Nderim Pasuli dhe Veton Rruka, me të cilët ka biseduar për bashkëfinancimin rreth promovimit të prodhimtarisë bujqësore në Mitrovicë, ngritjes së sipërfaqeve të kultivuara dhe certifikimit të fermerëve.

Të pranishëm në këtë takim ishin edhe nënkryetari i Lidhjes së Bletarëve të Kosovës, Zymber Bajraktari, si dhe zyrtarët komunalë, Bedri Sadiku dhe Hysnije Mikullovci. Qëllimi i këtij takimi ishte të prezantohej projekti i Caritasit zviceran "Prosperiteti i prodhimtarisë agrare në komunat e Kosovës nga investimet e qëndrueshme rurale- pasuri", duke synuar përmirësimin e kushteve jetësore të fermerëve, rritjen e gjenerimit të të hyrave dhe prodhimin bujqësor në Komunën e Mitrovicës.

Përmes këtij projekti synohet promovimi dhe prodhimi i frutave malore, mjaltit, bimëve mjekësore dhe frutave aromatike, certifikimi i fermerëve me standardet organike të prodhimit për kultivuesit e BMFA, edukimi, trajnimi dhe ngritja e vetëdijes së fermerëve për prodhimtarinë bujqësore si dhe themelimi i zinxhirit të vlerave për kultivuesit.

Drejtori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ekrem Sadiku, fillimisht ka falënderuar të pranishmit për iniciativën që e kanë ndërmarrë ata, duke e cilësuar këtë bashkëpunim të ndërsjellët dhe të frytshëm për fermerët mitrovicas. Ai ka theksuar se falë projekteve të tilla të cilit janë realizuar dhe po vazhdojnë të zbatohen te fermerët mitrovicas ka ndikuar dukshëm në rritjen e interesimit të fermerëve për t'u marrë me bujqësi. Ky projekt pritet të realizohet me participim të përbashkët, ku Caritasi zviceran do të financojë 50 për qind, Komuna e Mitrovicës 35 për qind dhe fermeri 15 për qind.

# Drejtoria e Inspektorateve në Prizren do t'i shqyrtojë kërkesat për pranimin e pllakave para betonimit

PRIZREN, 12 DHJETOR (ER) - Komuna e Prizrenit ka bërë me dije se Drejtoria e Inspektorateve do t'i shqyrtojë kërkesat për pranimin e pllakave para betonimit, punimet e të cilave planifikohen të bëhen në ditët e festave. Sipas njoftimit të kësaj komune, kjo drejtori do t'i caktojë ditët e punës për realizimin e këtyre punimeve. "Drejtoria e Inspektorateve, respektivisht Inspektorati Komunal i Ndërtimtarisë, tani e tutje nuk do t'i shqyrtojë kërkesat për pranimin e pllakave para betonimit, punimet e të cilave planifikohen të bëhen në ditët e festave dhe ditët e fundjavës. Me këtë rast, obligohen të gjithë pronarët e bizneseve ndërtimore, pronarët e objekteve kolektive dhe individuale, që në kërkesën e tyre për pranimin e pllakave të betonimit te Drejtoria e




Inspektorateve t'i caktojnë ditët e punës për realizimin e punimeve të tyre. Ky veprim i drejtorisë është marrë në bazë të kompetencave të plota ekzekutive sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm në fushën e zbatimit të rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.

# Vazhdon shenjëzimi i rrugëve të Malishevës

MALISHEVË, 12 DHJETOR (ER) - Në kuadër të mirëmbajtjes së rrugëve dhe krijimit të sigurisë dhe orientimit në rrugë, Komuna e Malishevës është duke vazhduar zbatimin e projektit për shenjëzimin e rrugëve dhe vendosjen e shenjave orientuese nëpër rrugët e kësaj komune. Për ta parë nga afër implementimin e këtij projekti, në terren ka dalë drejtori Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Milazim Morina. "Vendosja e shenjave dhe shenjëzimi i rrugëve është pjesë e mirëmbajtjes së rrugëve dhe krijimit të sigurisë në rrugë. Gradualisht shenjat e orientimit do të vendosen në të gjitha rrugët, kurse prioritet kanë rrugët që janë më të ngarkuara dhe aty ku shkollat janë afër", ka thënë Morina.



# Arkani e paramilitarët serbë kanë qenë hiçgjë në krahasim me zyrtarët shtetërorë të Serbisë

(Qeveritarëve të Serbisë dhe Vuçiqit duhet t'u thuhet: Ushtria e Kosovës as dje e as sot nuk do të udhëhiqet nga politika kriminale e gjenocidale për shfarosjen apo dëbimin e asnjë pakice kombëtare nga Kosova ashtu si ka vepruar dje i gjithë aparat shtetëror i Serbisë në Kosovë)



Nga Jakup KRASNIQI

Serbisë? Përpjekja për ta demonizuar Arkanin sot përtej asaj që ishte në raport me qeveritarët e Serbisë së Milloshheviqit, madje edhe në raport me cilindo komandant ushtarak e policor, është më shumë se amnisti e krimit dhe e gjenocidit serb të ushtruar në Kosovë nga regjimi i kriminelit Milloshheviq. Është e ditur se Arkanin, po ata që e kanë krijuar, edhe e kanë ekzekutuar kur s'ju është dashur më. Krijesa Arkan ishte e shtetit të Serbisë për t'ua lënë fajësinë e krimeve të kryera nga ushtria e policia e shtetit serb. Arkani nuk kishte ushtri, kishte hajna e banditë ordinerë që shteti i kishte liruar nga burgjet për t'i bërë mish për top në Kosovë. Të mendosh se Arkani ishte dikush, do të thotë t'i amnistosh kryerësit e fajtorët kryesorë të krimit dhe të gjenocidit serb të ushtruar jo vetëm në Kosovë nga aparati shtetëror i Serbisë. Këtë karrem nuk guxojmë ta pranojmë as 20 vjet pas luftës.

Të gjithë duhet ta dinë se Arkani e ndonjë bandit tjetër ordiner, në krahasim me pozitën e Vuçiqit, të Daçiqit, të Vulinit e të Dikoviqit, që kishin asokohe në aparatin e shtetit në Serbi, ishte një hiq. Ishte një hiq edhe në krahasim me secilin komandant brigade, batalioni e togu apo komandant policie të rajoneve a të stacioneve policore të Serbisë në Kosovë. Asnjë nga këta, bash me asgjë, nuk mund të krahasohen me Arkanin i cili nuk ishte më shumë sesa një hajn e bandit ordiner që pushteti e përdori për veprime kriminale. Kriminelët serbë në Kosovë ishin ata që ishin të veshur me fuqinë e pushtetit shtetëror serb në krye me Milloshheviqin. Në vitet e luftës në Kosovë askush nga paramilitarët nuk mund të krahasohet me fuqinë që kishin, ministra e zëdhënës të Qeverisë së Milloshheviqit, pra në asnjë mënyrë të bëmat kriminale të drejtuesve të ushtrisë e të policisë nuk mund të barasvlerësohen me ato të Arkanit. Ky i fundit ishte krijuar vetëm për t'i liruar nga fajësia, kriminelët e vërtetë të luftës në Kosovë. Prandaj, askush në Kosovë nuk duhet qoftë nga padija apo pavetëdija ta zmadhojë rolin e Arkanit e mos t'i apostrofojë përgjegjësit e vërtetë të krimeve e të gjenocidit serb në Kosovë.

Ta përfundoj: Arkani dhe paramilitarët e tjerë serbë, pa ombrellën e ushtrisë e të policisë serbe, ishin një hiçgjë! Prandaj askush në Kosovë e as gazetarë portalesh apo të tjerë nuk duhet të bien viktimë e mashtrimeve të kurdisura serbe në Kosovë. Kuptohet, nëse këtë nuk e bëjnë nga padija!

Qëllimi im me këtë shkrim është mos të gaboj askush, me qëllim e pa qëllim apo nga padija e t'i amnistojmë të paamnisturit, kriminelët e Serbisë të veshur me pushtet shtetëror edhe sot e kësaj dite, të cilët edhe nga pozitat e sotme shtetërore vazhdojnë kërcënimet për luftë të re kundër shqiptareve. Madje gëzojnë përkrahje edhe përtej Serbisë.

# Çdo i ftuar nga Gjykata Speciale duhet të informohet se në çfarë cilësie ftohet

Nga KMDLNj-ja

Zyrat e Specializuara apo Zyra e Specializuar e Prokurorit në Hagë, e që në Kosovës njihet si Gjykata Speciale, ka caktuar datat kur do të intervistohen persona të ftuar para kësaj Gjykate mirëpo, nëse u referohemi mbrojtësve të autorizuar të këtyre personave, përveç datës dhe vendit ku është ftuar X personi, nuk ceket cilësia e ftesës: si dëshmitarë, si të dyshuar apo si të akuzuar. Disa emra të të ftuarve janë bërë publikur përmes mbrojtësve apo edhe vetë të ftuarve mirëpo, sipas KMDLNj-së, ka të tillë që nuk e kanë bërë publike ftesën nga Gjykata Speciale e që është e drejtë e tyre dhe të cilët me asgjë nuk mund të detyrohen ta bëjnë publike ftesën, nëse Gjykata Speciale, përmes shërbimeve të caktuara që i ka, nuk i bënë publike këto ftesa. Deri më tani, nga shtatë ftesa për intervistim kemi vetëm një rast kur tregohet cilësia për çfarë ftohet, ndërsa në rastet e tjera nuk veprohet në përputhje me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara dhe Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive Themelore të Njeriut, Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike si dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Nëse në ftesën me shkrim drejtuar personave të ftuar para Gjykatës Speciale në Hagë për intervistim nuk tregohet se në çfarë cilësie ftohet dhe për këtë nuk informohet as i ftuari e as mbrojtësi i autorizuar e që duhet të jetë i pranishëm gjatë intervistimit, atëherë kjo paraqet shkelje të drejtave të njeriut për çfarë duhet të reagojë Ombudspersoni i Gjykatës Speciale dhe organizatat për të drejtat e njeriut kurse, për mbrojtje të ligjshmërisë dhe integritetit të procesit dhe të ftuarit, zyrtarisht duhet të reagojë mbrojtësi i autorizuar. Nëse bëhet fjalë për një intervistim për të cilin nuk ka nevojë të shkohet në Hagë, pas vlerësimit të Zyrës së Prokurorit dhe Dhomave të Specializuara - Gjykatës Speciale, ky intervistim mund dhe duhet të bëhet në Kosovë për faktin se kjo Gjykatë është pjesë e sistemit të drejtësisë në Kosovë dhe është votuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës. Në çdo rast, kur nuk saktësohet se në çfarë cilësie janë ftuar para Gjykatës Speciale personat që u janë përgjigjur vullnetarisht ftesës apo pas marrëveshjes me autoritetet përgjegjëse, KMDLNj-ja mund të dyshojë se ata ftohen si të dyshuar, se janë pjesë e aktakuzës dhe se mund të arrestohen, pas intervistimit i cili në këtë rast do të ishte vetëm formal.

Në mungesë të informimit për cilësinë e statusit për çka është ftuar dhe në mungesë të marrëveshjes midis autoriteteve të Gjykatës Speciale dhe personit të ftuar, personat e ftuar nuk bëjnë asnjë shkelje të ligjit nëse nuk i përgjigjen pozitivisht ftesës për intervistim.



KMDLNj fton të gjitha palët të përmbahen nga publikimi i listave se kush mund të ftohet, në çfarëdo cilësie para kësaj Gjykate apo se kush mund të arrestohet sepse kota janë vlerësime dhe që qëndrime arbitrare e që shkaktojnë huti në opinion duke shqetësuar personat e apostrofuar dhe familjet e tyre.

Autoritetet e Kosovës e që kanë marrë përgjegjësi për të gjitha shpenzimet për personat që do të jenë subjekt i trajtimit para kësaj Gjykate, duhet të vihen në veprim menjëherë duke i përmbushur të gjitha detyrimet; që nga dita e intervistimit, sigurimi të mbrojtjes ligjore, shpenzimet (të gjitha) për familjet e të trajtuarve para kësaj Gjykate, deri te monitorimi i proceseve gjyqësore dhe vizitat monitoruese të personave të privuar nga liria, shtetas të Kosovës. Shtetasit e Kosovës e që eventualisht privohen nga liria e që do të jenë subjekt i Gjykatës Speciale, pa vullnetin e tyre dhe familjeve të tyre po dërgohen larg vendit ku jetojnë dhe sipas Rregullave Evropiane të Burgjeve, Konventave Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut si dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duhet të jenë afër familjeve apo vendit ku jetojnë aq më parë që kjo Gjykatë, sipas autoriteteve të Kosovës qenka pjesë e sistemit të drejtësisë kosovare dhe, në trajtimin e tyre nuk mund të pezullohen ligjet e Kosovës.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut në Prishtinë e përkrah çdo gjykatë që i trajton viktimat si viktima, pa bërë dallime në baza etnike, gjinore, moshore, bindjeve politike apo statusit shoqëror sikur që kërkon përgjegjësi për të gjithë ata që planifikuan krimin, nuk e penguan krimin ndonëse kishin detyrim apo mundësi, urdhëruan krimin (niveli politik) apo e zbatuan krimin (hierarkia ushtarake dhe policore) gjithashtu, pa bërë dallim në çfarëdo baze.

KMDLNj fton të gjithë ata që thirren nga kjo Gjykatë e që e kanë të qartë në çfarë cilësie ftohen, të paraqiten vullnetarisht, të bashkëpunojnë me Gjykatën për zbardhjen e krimeve të pazbardhura në mënyrë që të sigurohet drejtësi për viktimat (për të gjitha dhe jo në mënyrë selektive) sikur edhe të sigurohet përgjegjësi për të gjithë ata që u dëshmohet fajësia, përtej dyshimeve të bazuara.

## Vladimir Putini, agjent sekret i STASI-t




BERLIN, 12 DHJETOR - Media gjermane "Bild" shkruan se në arkivat e STASI (Shërbimi i Sigurisë Shtetërore) është gjetur një kartë identiteti e Policisë sekrete të Gjermanisë Lindore, e cila thuhet se i përket presidentit rus Vladimir Putin. Ai thuhet se ishte agjent i KGB-së në Dresden në vitet 1985-1990. "Bild" ka publikuar një fotografi të kartës së identiteti të lëshuar për "Maj. Vladimir Putin", e nënshkruar dhe vërtetuar me pulla. Sipas medies gjermane, dokumenti është gjetur në dosjet e zyrës së STASI të Dresdenit për "kuadro dhe arsim". Konrad Felber, i cili kryeson degën e Dresdenit të autoritetit që mbikëqyr arkivat e STASI, i ka thënë "Bild" se dokumenti në fjalë do t'i lejonte Putinit të hynte dhe të largohej lehtësisht nga zyrat e STASI. Ai shtoi se kjo do të kishte bërë rekrutimin e agjentëve më të lehtë, sepse Putini nuk duhet t'i tregonte askujt se punonte për KGB-në.

# Kryeministrja May përballet me votë mosbesimi

Marrëveshja për daljen e Britanisë nga Bashkimi Evropian ka bërë që kryeministrja Theresa May të përballet me votë mosbesimi. Gjatë një adresimi para gazetarëve, May tha se do ta kontestojë votën me gjithë fuqinë që ka



LONDËR, 12 DHJETOR - Kryeministrja e Britanisë së Madhe, Theresa May, do të përballet me votë mosbesimi të mërkurën për shkak të marrëveshjes për daljen e Britanisë nga Bashkimi Evropian, që pritet të votohet në Parlamentin britanik. Gjatë një adresimi para gazetarëve, May tha se do ta kontestojë votën me gjithë fuqinë që kam.

May shtoi se një kryeministër i ri do të duhej të anulonte ose ta zgjeronte Artikullin 50, mekanizëm që e largon Britaninë nga Bashkimi Evropian më 29 mars, që mund të shkaktojë vonesë apo edhe anulim të Brexitit.

Votimi në Parlamentin britanik pritet të ndodhë të mërkurën pasdite në mes të orës 18:00 dhe 20:00 me orë lokale të Britanisë.

Kryeministrja May tha se ndryshimi i liderit të Partisë Konservatore do të çonte "vendin në rrezik dhe do të krijonte paqartësi në kohën kur më së paku na duhet". "Zgjedhjet për lidershipin e ri nuk do të ndryshonin bazën fundamentale të negociatave apo ritmin e Parlamentit", tha ajo. "Javët që mund të kalojmë duke shkatërruar veten mund të krijojnë më shumë ndarje në kohën kur ne duhet të qëndrojmë së bashku për t'i shërbyer vendit. Asnjëra nga këto nuk do të ishte në interesin kombëtar", tha May gjatë fjalimit.

May shtoi se është duke bërë progres në bisedimet me liderët e Bashkimit Evropian dhe u zotua për të çuar përpara votën e referendumit dhe të shfrytëzojë mundësitë e reja që vijnë. "Konservatorët duhet të ndërtojnë një shtet që funksionon për të gjithë dhe të çojnë përpara votën e Brexit-it për të cilën ka votuar populli", tha ajo. "Unë jam përkushtuar tërësisht ndaj kësaj detyre që kur mora postin e kryeministres dhe qëndroj e gatshme të përfundoj punën", tha May.

Sfida e pozitës së kryeministres May vjen pas dorëzimit të 48 letrave për kontestim që janë dorëzuar nga ligjvënësit.

Ish-ministri Owen Paterson, tha se May është mjerisht e përkushtuar të qëndrojë prapa marrëveshjes që nuk do të kalojë në Parlament dhe më keq, nëse nuk kalon, ajo do të humbiste përkrahjen e Partisë së Bashkimit Demokratik, që mund të çojë në zgjedhje të përgjithshme.

Theresa May, që ka shërbyer si kryeministre e Britanisë që nga periudha kur populli britanik votoi për dalje nga Bashkimi Evropian më 2016, është përballur me kritika nga partia e saj për planin e Brexitit të cilin e ka negociuar.

Rezultati i votimit të mbyllur mund që të kumtohet rreth orës 21:00, në kohë lokale, mund të përmbyset vetëm nëse May arrin të fitojë shumicën në favor të saj. Nëse ndodh kjo, May nuk mund të përballet me votë mosbesimi për të paktën edhe një vit tjetër. Nëse May nuk fiton shumicën, atëherë do të përballet me garën për lidershipin e partisë, në të cilën ka dobësim të përkrahjes. Opsioni i fundit është se, pavarësisht prej fitores së mundshme të Theresa May, ajo mund të vendosë të tërhiqet nga drejtimi i partisë.

## Merkeli: BE-ja nuk e ndryshon marrëveshjen e Brexitit



BERLIN, 12 DHJETOR - Kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel, tha të mërkurën se Bashkimi Evropian po këmbëngul në marrëveshjen ekzistuese për daljen e Britanisë nga blloku.

Merkeli, e cila të martën takoi kryeministren Theresa May, tha se gjërat po ndryshojnë në Londër, transmeton AP. Ajo nuk dha shumë detaje por shtoi se Bashkimi Evropian "nuk e ka ndërmend të ndryshojë marrëveshjen e tërheqjes së Britanisë së Madhe".

Merkeli shprehu angazhimin e Gjermanisë për të siguruar një dalje të rregullt të Britanisë nga Bashkimi Evropian.

Kryeministrja e Britanisë, Theresa May, ndërmori një tur bisedash me udhëheqësit evropianë, në përpjekje për t'i bindur ata që të ndryshojnë marrëveshjen e Brexitit, pasi e njëjta nuk e ka mbështetjen e Parlamentit britanik.

Nëse Britania largohet nga Bashkimi Evropian pa një marrëveshje, pasojat parashikohet të jenë në tregjet financiare dhe tregti.

## SHBA-ja dëshiron rivendosjen e kufizimeve ndaj Iranit

Nju Jork, 12 dhjetor - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, i tha Këshillit të Sigurimit të OKB-së, se Uashingtoni, do të punojë me anëtarët e përhershëm të Këshillit, për t'i rivendosur kufizimet ndaj raketave balistike të Iranit.

Në fjalimin e tij të mërkurën, në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit për Iranin, Pompeo, tha gjithashtu, se embargoja e armëve ndaj Teheranit nuk duhet të hiqet në vitin 2020. Ai i bëri thirrje Këshillit të Sigurimit të vendosë "masa inspektimi në portet dhe në det të hapur, për t'i penguar përpjekjet e vazhdueshme të Iranit për të anashkaluar kufizimet e armëve".

Takimi i Këshillit të Sigurimit vjen pasi një komandant i lartë ushtarak iranian konfirmoi se Teherani kohët e fundit bëri një provë të raketave balistike, veprim ky që u dënua nga fuqitë perëndimore. "Ne po vazhdojmë testet tona të raketave dhe kjo e fundit ishte një provë e rëndësishme", citonte agjencia e lajmeve Fars, komandantin e hapësirës ajrore Islamike Revolucionare të Korpusit, gjeneral brigade Amirali Hajizadeh.

Këshilli i Sigurimit u takua javën e shkuar për të diskutuar testin e dhjetorit, për të cilin, Shtetet e Bashkuara thanë se shkeli Rezolutën 2231 të OKB-së, e cila u miratua si pjesë e marrëveshjes



bërthamore të vitit 2015 midis Teheranit dhe fuqive botërore.

# PARODIA NË SKENËN E TEJDUKSHME

Nexhat REXHA

Faktori kohë në rrjedhat shoqërore bashkë me njeriun krijojnë të dukshmen dhe të tejdukshmen. Në realitetin e kohëve, ngjarjet krijojnë rrjedhën e tyre në mënyra nga më të ndryshmet, ato vijnë me fishkëllimat sporadike të valëve e të pakënaqësive nëpër aktualitetet e rrethanat politike. Libri me poezi satirike i Izet Abdylit "Fundi i perandorëve", në problematikën e shtjelluar, brenda poezive ka të ngjeshura pika të dalluara, të cilat specifikojnë me ngjarje e veprime të aktualitetit tonë. Izet Abdyli bashkëudhton me ngjarjet e Kosovës për disa dekada, duke qenë edhe vetë bartës i proceseve shtetëformuese në shoqërinë tonë. Nëpër këto procese, ai ka përjetuar nga afërsia luftën e krismave serbe dhe si protagonist i drejtpërdrejtë e bartës i përgjegjësive edhe në ditët më të vështira të fundshekullit të kaluar. Duke qenë përjetues i shumë skenave të rënda shoqërore, ai në shkrimet e tija ndjen kohët e dhembshme, sepse vetë ka ecur nëpër këto ngjarje të mundimshme. Duke i përjetuar në shpirtin e tij prej intelektuali ditët e vitet e rënda të robërisë, ato e rikthejnë penën e tij nëpër këto vlime që domosdo kërkojnë shpalim të faqeve historike. Poezia e këtij vëllimi është vazhdimësi e përditshmërisë së traumatizuar në shumë sfera të shoqërisë sonë. Në këto rrafshe të diktueshme të jetës me të papritura e pakënaqësi tek shumica e popullatës, vijnë edhe frymëzimet poetike, të cilat prekin shumë pika që shihen e diskutohen në përditshmëri. Kjo formë e komunikimit artistik në poezinë e sotme ka trajtim të paktë, ani pse poezia e sotme shkruhet me shumicë në kulturën tonë. Vetë realiteti politik në rrethanat e sotme është bë, e po bëhet vetë poezi satirike në disa fusha shoqërore.

Izeti duke bashkëjetuar në të gjitha këto procese me njeriun e vendlindjes dhe të gjitha trevave të Kosovës, ka depërtuar në përjetim të dilemave shoqërore që krijojnë objektiven e dhembshme në skenën politike. Vlera dhe antivlera e dijes si dhe e moralit të kësaj kohe, sikur po e nëpërkëmbin, njeriun e sakrificës e bartësit e proceseve të lirisë. Në këto depërtime, poezia e shkruar në këtë frymë lejon, krijon mundësi të prekjes së pikave të ndjeshme përmes fjalës sa të thjeshtë, po aq edhe artistike. Vetë zhanri i poezisë satirike të jep mundësinë e shkrirjes së figuracionit të dukshëm, në interpretim të asaj që ironizon me vetë faktorin kohë.

Krijimi i raporteve shoqërore në poezinë e Izetit krijon dimensionin përafrues të asaj që shihet e diskutohet në çdo pjesë të Kosovës. Poezia si e këtillë është ndërtuar në raportet e përditshmërisë, si element i veprimeve shoqërore në ndërtimin e shtetit të Kosovës. Njohja e prekja e gjërave nga afërsia, kanë krijuar motivimin depërtues në tematikën e parashtruar në vepër. Motivet poetike ndërlidhin karakteret e veprimet e qytetarit tonë në shumë fusha të jetës, ato krijojnë disonancat e tyre nëpër bashkëbisedimet e njerëzve. Tematika e shtruar në të gjitha poezitë e këtij vëllimi të ambienton në dialektikën e këtyre proceseve, si mundësi për të arrirë në kahet e zhvillimit politik dhe ngecjeve të shumta që e kanë kapluar vendin tonë. Mirëpo, brendia e poezive ka autencitetin e ndërtimit në




pikëpamje të përkufizimit të arrirë artistik.

Poeti ndërtimin e përgjithshëm artistik e konkretizon me shfaqjen e dukurive reale, me analogjitë e realitet pa diferencime, sepse vetë jeta dhe arti nëpër kohë ka aktualizuar se poezia satirike krijon mundësinë e shqiptimit të dukurive të dëmshme shoqërore. Kështu, në fokus vihet e ardhmja që dëmton imazhin dhe arritjet e nevojshme shoqërore, të cilat duhet të tejkalojnë kohët e robërisë. Arti i mirëfilltë në një mënyrë apo tjetër është katalizator ndihmues për largimin e të keqes në shoqëri. Theksimi identifikues përcakton edhe nivelin e fuqisë, që nënkupton shkallëzimet ekstreme të dallimeve e pritjeve të gjata në renditjen e vlerave njerëzore në shoqëri. Duke i përjetuar këto periudha e ndryshime, Izeti ato i aktualizon përmes vargut poetik, i cilëson si lidhje e radhitje të pakëndshme të proceseve tona. Libri "Fundi i perandorëve", është kompleks i shtresuar, për të arrirë në testamentin konkretizues, qoftë si shfaqje apo si aktualizim i rrjedhave që e kanë kapluar shoqërinë tonë.

Dokumentarit si përjetim e njohje ka shfaqjet e veta në shtrirjen e arsyes për të vlerësuar diturinë në realitetin e sotëm, dituria si vlerë, realitet dhe dituria si metaforë nuk konsistojnë në objektiven e të ardhmes. Shkollimi i lartë universitar, sot në hapësirat tona ka depërtuar, jo si avancim për të tejkaluar kohët e pengesave të diturisë, përkundrazi, arsimimi ka depërtuar në kuantitet modern. Në poezinë "Poshtë ka ra katandi", problemin e përshkallëzimit në këtë fushë, ndër më të rëndësishmet në ndërtimin e shtyllave kryesore të shtetit, artikulojnë në brendi vargjet përmes ligjërimit poetik, ata fiksojnë: "sot u ka ardh dita/ e vera kah dera/do që brenda natës/po bahen mastera".

Poezia përmes aktualizimeve të shumta ndihmon e ruan edhe proceset historike, të cilat komunikojnë me të gjitha shtresat njerëzore. Roli i njeriut në ndryshimet e proceseve politike në poezinë e Izetit është i hapur, si në poezitë: "Partitë te tepsia", "Halli i kulaqit", "Kamarier kryepari", "Monolog i plakut nga Drenica", "Aderimet partiake" etj, janë pikat më vrojtuese të autorit, të cilat krijojnë përshtypjet më funksionale në lexim dhe në përjetim. Këto refleksione e fjalë të mëdha nëpër fushata zgjedhore, peshojnë e rëndojnë sistemin e ngritjes së emocioneve nëpër tubimet e të gjitha partive politike, ato sikur rriten në kapacitetin e fjalëve mashtruese e boshe. Pastaj, vjen zhgënjimi dhe mos efikasiteti në zgjedhjen e më të duhurve. Sepse vetë atmosfera e një trivialiteti simpatizuesish, ngatërrojnë pikat kulminante të drekave e darkave nëpër këto fushata parazgjedhore. Dalja në skenën e televizioneve, shfaqet në motivet më të ulëta përmes disa protagonistëve, të cilët bëhen objekt bisedimesh për qytetarin e të gjitha shtresave. Niveli i ruajtjes së vlerave të emblemës kombëtare të UÇK-së, sikur me listat e fryra e ka irrituar autorin si shumë kënd në këtë kohë, sepse ai edhe vetë ishte në ballë të kësaj lufte në mbrojtje e ndihmë të qytetarit tonë, aty ku jetoi e veproi gjatë periudhës së luftës në Kosovë. Pastaj hierarkia politike ka tejkaluar elegancën e dukjeve nëpër portalet tona, ato sikur ia humbin imazhin vetë kryeprotagonistëve të kohës, sepse ata nuk janë kursyer nga syri i kamerës, kështu disa skena e shfaqje, kur reprizojnë në veprimet e tyre ato të kthejnë në zhgënjim. Shtrohet çështja, se a mund të ndryshohet bota me poezi?, logjikën e kohës ajo nuk ndryshon. Mirëpo, në botën e ndërdijen e shtresave më të ngritura të atdhetarizmës, bota e artit depërton në ngritjen e vetëdijes për të ardhmen e cilësdo shoqëri njerëzore qoftë ajo , e pse mos të ndikojë edhe në shoqërinë tonë.

Vepra e Izet Abdylit "Fundi i perandorëve", me satira poli(e)tike II, me të gjitha artikulimet e brendshme, gjatë shfletimit të saj të jep një frymëmarrje më të lehtë. Parodia nëpër vargje të krijon atmosferën e pushtetit të lirë në motivim të mospranimit e të paragjykimit të servuar. Grotesku si vërshim i të sotmes, së paku krijon qëllimin e admirimit në origjinën e fjalës së bukur artistike.

# Ministri i Kulturës kërkon themelimin e Shkollës Kombëtare të Baletit në Kosovë

PRISHTINË, 12 DHJETOR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, i ka shkruar letër ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqri Bytyqit, që ta themelojë Shkollën Kombëtare të Baletit në Republikën e Kosovës.

Kërkesa për themelimin e kësaj shkolle ka ardhur si iniciativë duke e parë si interes kombëtar si dhe për faktin se nuk ka një shkollë të këtillë apo institucion arsimor ku bëhet shkollimi dhe përgatitja e kuadrit për trupën e Baletit Kombëtar të Kosovës. "Kosova për momentin ka një trupë të vogël të Baletit në kuadër të Baletit Kombëtar të Kosovës, edhe pse shumë profesionale dhe që ka dëshmuar veten në shumë shfaqje në Kosovë dhe në shumë qendra të Evropës me performanca artistike dhe profesionale, si dhe në shumë bashkëpunime ndërkombëtare", është shprehur ministri Gashi në letrën drejtuar ministrit Bytyqi.

Ministri Gashi ka bërë me dije se është e nevojshme të themelohet një institucion arsimor që përgatit kuadro që në një plan afatgjatë të sigurojnë të ardhmen e qëndrueshme dhe cilësore të baletit në vendin tonë. "Duke marrë parasysh se zhvillimi i kulturës dhe veprimtarisë së Baletit në Kosovë kërkon përgatitje profesionale, është shumë e nevojshme, në të njëjtën kohë e rëndësishme për vendin tonë të themelohet



'Shkolla Kombëtare e Baletit' sipas standardeve ndërkombëtare, e cila do të do të përgatiste kuadro të reja për Baletin Kombëtar të Kosovës dhe për veprimtarinë e baletit në vendin tonë", ka theksuar ministri Gashi, duke shtuar se në lidhje me strukturën dhe veprimtarinë e përgjithshme të shkollës mund të themelohet një grup i përbashkët, i cili do të përgatiste në detaje organogramin e shkollës si dhe veprimtarinë e saj. "Si model mund ta marrim Shkollën Kombëtare të Baletit në Shqipëri", ka shpjeguar ministri, me shpresën se kërkesa e tij të përkrahet nga ministri Bytyqi.

Ministri Kujtim Gashi ka vlerësuar se kjo shkollë do t'i sigurojë vendit tonë breza të ri të balerinëve të cilët do të jenë të përgatitur dhe shkolluar nga kuadro profesionale dhe që do t'i ndihmojë Baletit Kombëtar të Kosovës dhe veprimtarisë së baletit në përgjithësi.

E jashtëzakonshme

# Defekti teknik mbush rrugën me çokollatë



Një rrugë në një qytet të Gjermanisë u shtrua me çokollatë, e cila u derdh nga një fabrikë dhe u ngurtësua menjëherë prej trotuarit të ftohtë. Një gazetë gjermane ka njoftuar se 'defekti i vogël teknik', që përfshinte një rezervuar, shkaktoi derdhjen e ëmbël nga fabrika e çokollatës 'DreiMeister' në Westoennen. Banorët e qytetit Westonenn mbetën të habitur kur panë rrugën e mbushur me shtresë të ëmbël. Rreth 25 zjarrfikës u desh ta hiqnin nga rruga çokollatën.

FOTO E DITES




Një djalë pakistanez bartë mbeturinat plastike me një qerre me kali në Lahore. /AFP/

E rrallë

# Avioni i mbuluar me diamante 'çmend' internetin



Një imazh i pabesueshëm i një avioni të mbuluar me diamante është bërë viral në internet. Në fotografinë mahnitëse, e cila 'çmendi' internetin, shihet një Boeing 777 me bazë në Dubai. Por, doli se nuk ishte ashtu siç dukej, imazhi ishte rezultat i një "Photoshopi". Avioni i mbuluar me diamante ishte vepër e Sara Shakeel. Ajo e fotografoi në Islamabad, para se të fluturonte në qytetin italian të Milanos.

## BARSOLETA E DITËS



**Pacienti: Doktor, kam pirë benzinë. Çfarë të bëjë?**
**Doktori: Shumë, a?**
**Pacienti: Goxha, valla!**
**Doktori: Ani ec derisa të harxhohet, po mos pi më.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC



### "ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

**Vetem gjate vikendit në ora 14:00**



**Në ora 16:00**

### "JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

**Rolet:** Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
**Regjia:** David Kerr

**Në ora 18:00**

### "NIGHT SCHOOL"



Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
**Regjia:** Malcolm D. Lee



**Në ora 20:00**

### "SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

**Rolet:** Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
**Regjia:** Matthew Ross

**Në ora 22:00**

### "VENOM" 3D,



Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

**Rolet:** Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Nuk është se keni arritur të zgjidhni çështje që ju kanë shqetësuar këto kohë. Kjo gjë ju ka sjellë më shumë stres se zakonisht.



**DEMI**
Keni fituar pavarësi morale dhe financiare nga e shkuara juaj. Për këtë arsye jeni bërë më tolerant dhe më të hapur me të tjerët.



**BINJAKËT**
Një detaj që po ju ha shumë kohë dhe po ju mundon sot më në fund do të gjejë zgjidhje. Ju doni të jeni i përkryer dhe t'ia arrini qëllimit.



**GAFORRJA**
Keni filluar të keni më shumë besim te personat që ju rrethojnë dhe jo gjithmonë shtyheni nga instinkti për të zgjidhur një problem.



**LUANI**
Nuk keni shumë kohë për mëdyshje dhe dyshime sot. Njerëzit tuaj të dashur do t'ju kërkojnë ndihmë dhe duhet të jeni të gatshëm.



**VIRGJËRESHA**
Keni zgjedhur mënyrën më të thjeshtë për të mos pranuar ndjenjat tuaja, duke shmangur një person të caktuar. Do të pendoheni më vonë.



PESHORJA
Komunikimi është shumë i rëndësishëm sot. Nëse nuk bisedoni si me kolegët ashtu edhe me partnerin, çështjet e mbartura nuk do të gjejnë zgjidhje.



**AKREPI**
Një person ka krijuar një ide të gabuar për ju që nuk i korrespondon realitetit. Nëse doni të sqaroheni, mund ta ftoni për një takim.



**SHIGJETARI**
Keni vënë baza të forta për të ardhmen tuaj profesionale dhe jeni mjaft të qetë ndaj çdo ndryshimi që mund të ndodhë.



**BRICJAPI**
Duhet t'i mirëkuptoni pjesëtarët e familjes sot që nuk do të aprovojnë një vendim tuajin që, dashur padashur, i kushtëzon edhe ata.



**UJORI**
Nuk keni zgjidhje tjetër sot përveçse ta merrni në dorë situatën dhe të mundoheni t'i zgjidhni ngërçet e krijuara sepse mund t'ju prishin punë.



PESHQIT
Keni qenë shumë të ndjeshëm ndaj ngjarjeve dhe personave që keni pasur pranë, por tashmë keni ndryshuar qëndrim nisur nga një situatë e caktuar.

# Ronaldo u jep fund thashethemeve për martesën



Cristiano Ronaldo mohon zërat se ai dhe Georgina Rodriguez do të shkojnë së shpejti në altar. Të paktën tash për tash nuk bën pjesë në planet e tij. Në një intervistë për mediat portugeze, CR7 ka mohuar se ka nisur përgatitjet për ceremoninë martesore. "Martesa? Jo tani, por jua shpjegoj të gjithën. Unë shkoj çdo javë në kishë. Jam katolik dhe shkoj për ta falënderuar Zotin që ma mbron familjen dhe miqtë e mi. E ndërroj kishën çdo javë, sepse në Torino ka shumë dhe mund të zgjedhësh. Një 'paparac' një herë më pa dhe mendoi se po përgatitesha për t'u martuar", ka thënë Ronaldo.

# Eliminimi i Interit, Wanda në lot për Icardin



Wanda Nara qan për Mauro Icardin. Nuk bëhet fjalë për probleme mes çiftit, por për eliminimin e sulmuesit bashkë me Interin nga kampionati. Modeluesja argjentinase, e cila ishte e pranishme në "San Siro" për ndeshjen me PSV-në, e fundit në grupe, nuk e ka përmbajtur veten për shkak të zhgënjimit të thellë. Bashkëshortja e Icardit, autorit të golit të vetëm të Interit, shpërtheu në lot bashkë me djalin.



# I dashuri i Dua Lipës, krenar me të

Shqiptarja Dua Lipa ka shënuar suksese të mëdha në karrierë këtë vit. Dua javën që ka shkuar ka dhënë një intervistë për revistën "Vogue", në të cilën ka folur për shumë gjëra, të arriturat e saj përgjatë viteve. Por, përveç këngëtares, këtë sukses po e gëzon edhe i dashuri i saj Isaac Carew, i cili po thotë se është krenar për të dashurën. Ai në "Instastory" ka publikuar një fotografi të revistës "Vogue" ku në ballinë është Dua. "Kjo është e dashura ime, kështu që unë do ta marr të gjithë raftin… Pothuajse", ka shkruar Carew.

# Çifti Beckham në krizë



Përpjekjet e Victoria Beckhamit për të hequr një tatuazh dedikuar bashkëshortit të saj, David, duket se kanë rezultuar të suksesshme. Në mbrëmjen e "British Fashion Awards" ajo ka zbuluar se gjithçka është zhdukur dhe kanë mbetur vetëm disa shenja të vogla. Victoria ka dashur që në vitin 2015 ta heqë tatuazhin i cili lexonte në gjuhën hebraike: "Unë jam e të dashurit tim dhe i dashuri im është i imi". Ky tatuazh bën pjesë në listën e atyre që Victoria i ka cilësuar si shumë të sikletshëm. Megjithatë, ky veprim nuk do të thotë se ajo dëshiron të distancohet nga Davidi, përkundrazi në ngjarjen e mbajtur ata janë shfaqur shumë të lumtur përkrah njëri-tjetrit.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com
Montimi
Servisim
Porosi

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| OLYMPIACOS - AC MILAN | GG | FC COPENHAGEN - BORDEAUX | 1 | PAOK SALONIKA - BATE BORISOV | 1 |

# Flamurtari shlyen borxhet ndaj lojtarëve, por Thaqi mund të largohet

Kryetari i KF Flamurtari, Imer Ademi, i ka gëzuar futbollistët kuqezi me kryerjen e obligimeve ndaj tyre. "Kryetari i klubit i ka kryer të gjitha obligimet ndaj futbollistëve dhe kjo gjë është një për t'u përshëndetur", ka thënë Arsim Thaqi, i cili ende nuk ka vendosur se a do ta vazhdojë punën në skuadrën kryeqytetase apo do të largohet

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**



PRISHTINË, 12 DHJETOR - Flamurtari ka kryer obligimet tremujore që kishte ndaj futbollistëve. Lajmin për gazetë e ka konfirmuar të mërkurën trajneri Arsim Thaqi. "Kryetari i klubit i ka kryer të gjitha obligimet ndaj futbollistëve dhe kjo gjë është një për t'u përshëndetur", ka thënë Thaqi, i cili ende është i pavendosur për të ardhmen, ani pse kontrata e tij me klubin kryeqytetas është deri në fund të kampionatit.
Strategu në fjalë ka qenë më meritori për formën e mirë të klubit, sidomos në xhirot e para të kampionatit, duke mposhtur edhe skuadrat pretendente për titull. "Kam kontratë me Flamurtarin deri në fund të kampionatit, por brenda javës do të ulem dhe të bisedojmë me kryetarin për ta parë projektin që ka klubi. Gjithçka mund të ndodhë, ani pse dëshira ime është të punoj në këtë klub ashtu siç e kemi edhe kontratën", ka shtuar Thaqi, duke lënë të nënkuptohet se gjithçka rreth përforcimeve dhe largimit të futbollistëve do të vendoset në këtë takim me kryetarin e klubit.
Flamurtari në kampionatin e kaluar mezi e siguroi mbetjen në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, kurse në këtë edicion pati paraqitje shumë të mirë, ku për disajavë ishte edhe lider i elitës. Kjo skuadër është eliminuar nga Kupa, kurse trajneri Arsim Thaqi kërkon që skuadra të qëndrojë me këmbë në tokë dhe të luftojë për ta siguruar mbijetesën. "Kemi pasur rezultate të mira dhe me pak fat kemi mundur të kemi më shumë pikë të grumbulluara dhe të jemi në pozitë më të lartë. Megjithatë, duhet të jemi të kënaqur me atë që kemi arritur për faktin se në klub na kanë përcjellë disa probleme. Nuk kemi shumë pikë larg skuadrave të fundit. Synimi ynë është mbetja në Superligë", ka deklaruar ish-trajneri i Prishtinës dhe 2 Korrikut.
Skuadra e Flamurtarit sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e shtatë me 22 pikë, ku nga shtatëmbëdhjetë ndeshje regjistroi gjashtë fitore, katër barazime dhe shtatë humbje.

# Kryeministri Haradinaj: Qeveria do ta mbështesë Istogun në rrugëtimin drejt majave të hendbollit botëror



PRISHTINË, 12 DHJETOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka pritur në takim klubin e femrave në hendboll, Istogun. Me këtë rast Haradinaj ka premtuar përkrahje për këtë klub në rrugëtimin drejt majave të hendbollit botëror. "Sportistët përditë po na japin mesazhin fantastik se me këmbëngulje mund të kalohen edhe sfidat më të mëdha. Gjatë takimit me anëtaret e klubit hendbollistik të femrave 'Istogu' i përgëzova për arritjen në të tetën e finales së Challenge Cup, duke u renditur në mesin e 16 ekipeve më të mira të Evropës. Ndonëse ekipi më i mirë në Kosovë, e dhimbshme që ende është pa adresë të vetën, pa palestër në qytetin e tyre. Qeveria do t'i mbështesë ato në rrugëtimin drejt majave të hendbollit botëror", ka shkruar Haradinaj për "Facebook".

## SHKURT

### UEFA përkrah FFK-në

Presidenti i UEFA-s, Aleksandër Çeferin, ka pritur në selinë e vet kryetarin e Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe sekretarin e përgjithshëm Eroll Salihu. Presidenti Çeferin i ka dhënë përkrahje të fuqishme dhe të vazhdueshme FFK-së si dhe ka shprehur gatishmërinë për ta përkrahur strategjinë dhe projektet të cilat ia ka paraqitur kryetari i FFK-së. "Presidenti i UEFA-s u shpreh i mahnitur me zhvillimin, organizimin dhe punën e FFK-së dhe përgëzoi kryetarin Ademi për punën e tij, si dhe për rezultatet e ekipeve kombëtare të të gjitha kategorive, sidomos të Përfaqësues A. Çeferin shprehu dëshirën ta vizitojë sërish Kosovën dhe ta shikojë nga afër edhe një ndeshje të kualifikimeve për Evropianin 2020 në stadiumin 'Fadil Vokrri'", thuhet në njoftimin e FFK-së. Ndërkaq drejtuesit e Federatës së Futbollit të Kosovës e falënderuan për pritjen dhe përkrahjen presidentin e UEFA-s, Aleksandër Çeferinin.

### Kosova, dy rekorde në Botërorin e Notit

Kosova ka vendosur dy rekorde të reja në ditën e dytë të Kampionatit Botëror të Notit në pishina të shkurta 25m që po zhvillohet në Hangzhou të Kinës. Dren Ukimeraj në disiplinën 200m Krol pati kohën 01:58:44 dhe është rekord i Kosovës, në renditjen e përgjithshme, kurse Dreni u rendit i 58 nga 64 sportistët pjesëmarrës. Fjorda Shabani në disiplinën 100m krol pati kohën 01:02:09 në renditjen e përgjithshme dhe u rendit e 68-ta nga 94 sportiste pjesëmarrëse. Dion Kadriu në disiplinën 100m delfin arriti kohën 00:59:96 dhe është rekord i Kosovës. Në renditjen e përgjithshme Dioni u rendit i 67-ti nga 77 sportistët pjesëmarrës.

### Berisha merr nënshtetësinë australiane

Sulmuesi nga Kosova, Besart Berisha, ka marrë nënshtetësinë e Australisë pasi javën e kaluar ka kompletuar formalitetet në Melbourne. Berisha i dha fund qëndrimit katërvjeçar te Melbourne Victory për ta provuar fatin në ligën japoneze me ekipin Sanfrece Hiroshima. Sulmuesi që theu çdo rekord të golave në Australi ka edhe një vit kontratë me klubin japonez, por mungesa e paraqitjeve ka nisur raportimet se sulmuesi i Kosovës mund të jetë në lëvizje përsëri. Gjatë karrierës në Australi, Berisha ka realizuar 116 gola në 184 paraqitje.

## Wilderi: Joshua po m'u përgjërohet për t'u përballur



TUSCALOOSA, 12 DHJETOR - Boksieri Deontay Wilder ka pretenduar se ekipi i Anthony Joshuas është duke e përgjëruar atë për një meç mes këtyre të dyve. Fituesi i këtij meçi do të shpallej kampion i unifikuar në boks. Joshua i mban titujt IBF, WBO dhe WBA, ndërsa Wilderi arriti ta mbrojë titullin WBC në meçin kundër Tyson Furyt, i cili u zhvillua në fillim të këtij muaji dhe përfundoi baras. "Ata janë duke m'u përgjëruar tani. Ai po tenton të kontaktojë me mua paprit-mas dhe menaxherët e tij po tentojnë të kontaktojnë me menaxherët e mi. Por, ai mund ta kishte pasur këtë mundësi. Ai kishte shumë mundësi. Ai mund të ishte ndeshur me Luis Ortizin, mund të ishte ndeshur me mua dhe e kishte mundësinë për t'u ndeshur edhe me Furyn. Njerëzit duan ta dinë se kush është më i mirë tani, veçanërisht pas meçit me Furyn", ka thënë Wilderi, i cili ndihet më i miri deri kur të mposhtet nga dikush.

# Milanit i mjafton barazimi për kualifikim



ATHINË, 12 DHJETOR - AC Milan përballet me një ndeshje vendimtare për kualifikim në raundin tjetër të Ligës së Evropës dhe një fitore, por edhe një barazim i mjafton këtij skuadre për të arritur një synim të tillë. Kundërshtare e skuadrës kuqezi është Olympiacosi që, në rast fitore, mund ta sigurojë kualifikimin. Milani mund të marrë edhe pozitën e parë në grup nëse Dudelange i nxjerr barazim skuadrës spanjolle Real Betis.
Grup interesant është Grupi G, ku të gjitha skuadrat kanë shansin për kualifikim. Villarreali luan ndaj Spartak Moskës dhe një pikë do t'i mjaftonte për kualifikim, kurse rusëve u duhet vetëm fitorja. Në ndeshjen tjetër Rapid i Vjenës e pret skuadrën e Rangersit, ku luan shqiptari Eros Grezda. Skuadrës austriake i mjafton edhe barazimi, kurse skocezëve u duhet vetëm fitorja. Nga Grupi L, Chelsea e ka siguruar kualifikimin dhe skuadra tjetër do të vendoset pas ndeshjeve të fundit dhe me gjasë mund të jetë BATE Borisov.

### GRUPI A

21:00 AEK Larnaca - Bayer Leverkusen
21:00 Ludogorets - Zuerich

Tabela

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Bayer L. | 5 | 10 |
| 2. Zuerich | 5 | 9 |
| 3. AEK L. | 5 | 5 |
| 4. Ludogorets | 5 | 3 |

### GRUPI E

21:00 Arsenal - Qarabag
21:00 Sporting - Vorskla Poltava

TABELA

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Arsenal | 5 | 13 |
| 2. Sporting | 5 | 10 |
| 3. Vorskla Poltava | 5 | 3 |
| 4. Qarabag | 5 | 3 |

### GRUPI I

18:55 Besiktas - Malmoe FF
18:55 Genk - Sarpsborg

TABELA

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Genk | 5 | 8 |
| 2. Besiktas | 5 | 7 |
| 3. Malmoe | 5 | 6 |
| 4. Sarpsborg | 5 | 5 |

### GRUPI B

21:00 Celtic - Salzburg
21:00 Leipzig - Rosenborg

TABELA

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Salzburg | 5 | 15 |
| 2. Celtic | 5 | 9 |
| 3. Leipzig | 5 | 6 |
| 4. Rosenborg | 5 | 0 |

### GRUPI F

21:00 Dudelange - Real Betis
21:00 Olympiacos - Milan

TABELA

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Real Betis | 5 | 11 |
| 2. Milan | 5 | 10 |
| 3. Olympiacos | 5 | 7 |
| 4. Dudelange | 5 | 0 |

### GRUPI J

18:55 Akhisarspor - Standard Liege
18:55 Sevilla - Krasnodar

TABELA

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Krasnodar | 5 | 12 |
| 2. Sevilla | 5 | 9 |
| 3. Standard Liege | 5 | 9 |
| 4. Akhisarspor | 5 | 0 |

### GRUPI C

21:00 Koebenhavn - Bordeaux
21:00 Slavia Prague - Zenit

TABELA

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Zenit | 5 | 11 |
| 2. Slavia Prague | 5 | 7 |
| 3. Koebenhavn | 5 | 5 |
| 4. Bordeaux | 5 | 4 |

### GRUPI G

18:55 Rapid W. - Rangers
18:55 Villarreal - Spartak Moscow

TABELA

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Villarreal | 5 | 7 |
| 2. Rapid Wien | 5 | 7 |
| 3. Rangers | 5 | 6 |
| 4. Spartak M. | 5 | 5 |

### GRUPI K

18:55 Dynamo Kyiv - Jablonec
18:55 Rennes - Astana

TABELA

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Dynamo Kyiv | 5 | 11 |
| 2. Astana | 5 | 8 |
| 3. Rennes | 5 | 6 |
| 4. Jablonec | 5 | 2 |

### GRUPI D

21:00 Dinamo Z. - Anderlecht
21:00 Spartak T. - Fenerbahce

TABELA

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Dinamo Z. | 5 | 13 |
| 2. Fenerbahce | 5 | 8 |
| 3. Spartak Trnava | 5 | 4 |
| 4. Anderlecht5 2 | | |

### GRUPI H

18:55 Lazio - Eintracht Frankfurt
18:55 Marseille - Apollon Limassol

TABELA

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Eintracht F. | 5 | 15 |
| 2. Lazio | 5 | 9 |
| 3. Apollon L. | 5 | 4 |
| 4. Marseille | 5 | 1 |

### GRUPI L

18:55 PAOK - BATE Borisov
18:55 Vidi - Chelsea

TABELA

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Chelsea | 5 | 15 |
| 2. BATE Borisov | 5 | 6 |
| 3. Vidi | 5 | 6 |
| 4. PAOK | 5 | 3 |

## Toronto 'leksion' clippersave, triumfojnë Houstoni dhe Spursi

Houston, 12 dhjetor - Tri ndeshje të luajtura në NBA, por në fushë kanë zbritur disa nga ekipet pretendente për titull. Toronto ka fituar 123-99 ndaj Clippersit, përballja e dy prej ekipeve kryesuese në Konferencat përkatëse, ndeshje e luajtur në Los Anxhelos. Një ndeshje e mirë e skuadrës kanadeze, që u shkëput që në pjesën e parë, për të thelluar edhe më shumë shifrat në vijim, sfidë ku për miqtë u dalluan Ibaka me 25 pikë e Lowry me 21 (50 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit).



Rikthehet te fitorja ekipi i Houstonit, që mundi 111-104 Portlandin, ndeshje me rivalitet, fituar nga teksanët vetëm në periodën e fundit. Harden realizoi 29 pikë, më i miri në fushë, mbështetur edhe nga veteran Chris Paul, që realizoi një "triple double" (11 pikë, 11 rebounde dhe 10 asistime). Fiton edhe skuadra e San Antonios që, falë 24 pikëve e 11 reboundeve të Forbes, mundi 111-86 Phoenix, ndeshje e dominuar nga basketbollistët e Spursit, që i largohen fundit të renditjes.

REZULTATET

| | |
|---|---|
| Houston - Portland | 111-104 |
| San Antonio - Phoenix | 111-86 |
| Clippers - Toronto | 99-123 |

## SHKURT

### Llorisi: Kualifikimin e kuptuam nga tifozët

Tottenham Hotspuri u kualifikua në 1/8 e finales në Ligën e Kampionëve pas barazimit me Barcelonën (1-1). Portieri Hugo Lloris ka bërë me dije se kualifikimin futbollistët e kuptuan pas reagimit të tifozëve. "Është e vërtetë se patëm ndihmën e PSV-së. Ishte e vështirë pas golit të disavantazhit të shpejtë, por ne ruajtëm parimet tona dhe luajtëm shumë mirë. Nuk fituam, por u kualifikuam. Shpirti ishte fantastik. E meritojmë kualifikimin. E kuptova nga reagimi i tifozëve që u kualifikuam", ka thënë Lloris.

### Van de Beek-De Jong zëvendësojnë Robbenin dhe Riberyn

